



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Liberalizimi i vizave për Kosovën

analizë krahasuese

Hyrje

Që nga inicimi si ide liberalizimi i vizave konsiderohet ndër përfitimet më të prekshme për qytetarët e pjesës së Ballkanit të mbetur jashtë BE-së. Kjo pasi që, së pari, kontribuon në eliminimin e barrierave psikologjike në mes të këtyre shoqërive në tranzicion dhe në raport me shoqëritë e BE-së. Së dyti, procesi nxit reforma kyçe institucionale në këto vende. Këto reforma janë më të fokusuara, kryhen më shpejt se reformat e gjata e gjithëpërfshirëse të lidhura drejtpërdrejt me përafrimin e *Acqui*-së së BE-së dhe kondicionalitetin e bashkimit BE-së si anëtar me të drejta dhe obligime të barabarta. Kjo pasi që reformat e kërkuara për liberalizimin e vizave prekin një gamë më të ngushtë fushash, në thelb janë teknike, dhe kështu ofrojnë parashikueshmëri dhe objektivitet të vlerësimit të arritjeve në rrugë e sipër për t'u bërë pjesë e 'Listës së Bardhë Schengen'. Së treti, të paktën siç perceptohet nga këto vende dhe siç promovohet nga liderët e tyre politikë, liberalizimi i vizave kontribuon në nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik të tyre. Madje mund të argumentohet se shpejtësia e realizimit të kësaj perspektive ndikon edhe në shkallën e euro-skepticizmit në një shoqëri në tranzicion që aspiron integrimin në BE. Më tej, pasi që BE për vite të tëra e promovon vetveten si 'fuqi normative' në mesin e këtyre shoqërive, qytetarët në këto shoqëri e kanë parimin e trajtimit të barabartë si kriter themelor në formësimin të pikëpamjeve dhe qëndrimeve të tyre në raport me procesin e integritit evropian dhe BE-në si 'fuqi normative'. Prandaj ata presin që BE të udhërrëfejë transformimet e shumfishta nëpër të cilat duhet të kalojë secila shoqëri deri në integrimin e plotë në BE.

Kur flasim për Kosovën, të gjitha tregimet e suksesshme për përfitimet nga liberalizimi i vizave mbeten një përshtypje për një të ardhme që çdoherë e më tepër duket se po bëhet 'objektiv në lëvizje'. Fillimi i dialogut për liberalizimin e vizave iu premtua Kosovës nga ana e BE-së para rreth tre vjetësh, e sipas premtimeve të Kryeministrit Thaçi, gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të nëntorit 2009, Kosova do të duhej të ishte bërë pjesë e 'Listës së Bardhë Schengen' në fund të janarit 2012. Në përgjigje të presionit, dhe pas vonesave të njëpasnjëshme nga ana e BE-së, ka interpretime të ndryshme të këtij premtimi politik të Kryeministrit dhe Ministrave Rexhepi e Çitaku, të cilat mund të përmbliidhen në dy opsione, ose se do të fillonte dialogu brenda 15 muajve nga tetori 2009, ose se do të arrijmë të përmbushim kriteret brenda 15 muajsh nga fillimi i dialogut. Ka mundësi që ky premtim politik i PDK-së të jetë pasojë e (keq)interpretimit të 'Studimit për Kosovën', të tetorit 2009, ku Komisioni Evropian kishte premtuar diçka të ngjashme, por opsionin e parë tashmë do të donte ta harronte edhe vetë Kryeministri, kurse të dytin e konteston BE si diçka jorealiste, marrë parasysh kapacitetet e institucioneve për të përmbushur të gjitha kriteret.

Por, problematike mbetet se BE asnjëherë nuk i është përgjigjur këtij premtimi politik me një 'kundër-premtim' të prekshëm dhe realist. Më tej, përderisa BE vazhdon të relativizojë validitetin e kriterëve duke shtuar vazhdimisht kriteret e reja, apostafat për Kosovën, brenda kriterëve, ajo duket se po rrezikon relativizmin e tyre të skajshëm. Rrjedhimisht, edhe në përpjekje për ta neutralizuar mungesën e konsensusit në mesin e shteteve anëtare rreth statusit politik të Kosovës, 'fuqia normative BE' mban një pjesë të përgjegjësisë. Kjo pasi që po perceptohet si e pafuqishme për të vepruar politikisht në përputhje me parimin themelor të drejtësisë, atë të trajtimit të barabartë. Kombinuar me mospasë të tjera të saj në raport me Kosovën, BE rrezikon të minojë kontributin e pazëvendësueshëm të saj, deri më tani dhe në vijim, në zhvillimin e deritanishëm të Kosovës.

Kjo analizë krahasuese synon të nxisë diskutime më të informuara publike mbi perspektivën e liberalizimit të vizave për Kosovën duke ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të arritjeve të deritanishme, dhe duke i krahasuar ato me arritjet e dy vendeve fqinje (Shqipërisë dhe Maqedonisë) në kohën kur ato i ishin bashkuar 'Listës së Bardhë Schengen'. Një synim tjetër është që të kontribuojmë në përcaktimin e prioriteteve në fushat relevante për liberalizimin e vizave. Së treti, synojmë që të ushtrojmë presion mbi Qeverinë dhe institucionet e tjera publike relevante për këtë proces, por edhe mbi BE-në, që të konsultojnë shoqërinë civile gjatë dialogut për liberalizimin e vizave, i cili është premtuar të fillojë në mars të këtij viti, si dhe të jenë më transparente dhe llogaridhënëse ndaj publikut të gjerë.

I. Ecuria e përgatitjeve për marrjen e udhërrëfyesve për liberalizimin e vizave

Duke parë përparimin e vendeve fqinje në procesin e liberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian (me plan heqjen e regjimit të vizave me shtetet e zonës Schengen për shtetasit e Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë, në dhjetor 2009), nga njëra anë, dhe mungesën e vullnetit politik nga ana e BE-së për të iniciuar procesin e liberalizimit të vizave edhe me Kosovën, nga ana tjetër, autoritetet politike të kësaj të fundit vendosën, në shtator 2009, për të filluar njëanshëm plotësimin e kriterëve teknike të kërkuara për këtë proces. Duke marrë për bazë përmbajtjen e udhërrëfyesve të BE-së dhënë vendeve fqinje, dhe si pikënisje gjendjen e atëhershme të reformave të kërkuara në fushat relevante në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit, më 7 maj 2009 Qeveria e Kosovës miratoi *Udhërrëfyesin për Implementimin e Kriterëve për Procesin e Liberalizimit të Vizave në mes të Kosovës dhe Bashkimi Evropian*.¹ Pas miratimit të Udhërrëfyesit, Qeveria miratoi, më 15 tetor 2009, një Plan Veprimi² për implementimin e tij, kurse më 22 dhjetor 2009 u themelua grupi punues³ përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e këtij plani veprimi. Duke qenë përgjigje e njëanshme, në thelb politike, ndaj insistimit të BE-së që çfarëdo marrëdhënie me Kosovën të kufizohej ekskluzivisht në nivel të dialogut teknik (rrjedhimisht pa vendime politike, siç është dhënia e udhërrëfyesit zyrtar dhe fillimi i dialogut), ky veprim i Qeverisë së Kosovës në vetvete ishte edhe rezultat i presionit të shtuar nga akterë të ndryshëm vendorë, në veçanti nga partitë politike opozitare dhe akterë të shoqërisë civile, në prag të heqjes së vizave vendeve fqinje.

Ky lloj presioni në fillim kryesisht përshkohej nga bindja se Kosova ishte vonuar në përmbushjen e kriterëve teknike dhe se fillimi i përmbushjes së tyre do të paraqiste demonstrim të mjaftueshëm të vullnetit politik në raport me institucionet e BE-së për të përfshirë Kosovën në këtë proces ndaras nga vendet e rajonit, dhe bazuar në kërkesa dhe trajtim të barabartë si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Në këtë mënyrë, në njëfarë mase neglizhohej roli i Këshillit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të BE-së, përkatësisht i shteteve anëtare në kuadër të tyre (si vendimmarrësit më të lartë politikë të BE-së), në dhënien e dritës së gjelbër Komisionit Evropian që mbase edhe dialogun teknik në kuadër të kornizës së *kuazi*-procesit të stabilizim-asociimit ta orientonte drejt përmbushjes së kriterëve për fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave, Megjithatë, edhe pas përpjekjesh prej mbi dy vjetësh të autoriteteve dhe akterëve të tjerë në Kosovë për të siguruar fillimin e këtij dialogu, BE nuk ka arritur të dëshmojë një gjë të tillë në asnjë nga vendimet dhe dokumentet e saja politike (qofshin ato për Ballkanin Perëndimor në përgjithësi, qofshin për Kosovën në veçanti).

Një nga dokumentet më të rëndësishme politike, në kontekstin e përgjithshëm të perspektivës së integritimit në BE të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, janë Konkluzionet e Samitit të Selanikut, të 21 qershorit 2003. Qysh atëherë BE shpalli përkushtimin e vet politik për t'u ofruar të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor perspektivën e liberalizimit të regjimit të vizave. Në njërën nga pikat e Deklaratës politike të dalë nga ky samit renditen fushat më të rëndësishme ku duhet të përmbushen kriteret për fillimin e procesit të liberalizimit të vizave: “Ne njohim rëndësinë që popujt e Ballkanit Perëndimor i kushtojnë perspektivës së liberalizimit të regjimit të vizave të BE-së për ta. Ne njohim se progresi varet nga zbatimi i reformave madhore në fusha të tilla si forcimi i *sundimit të ligjit, lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe migrimit ilegal*, dhe forcimi i kapaciteteve administrative për *kontrollin e kufijve dhe sigurinë e dokumenteve*. Vendet e Ballkanit Perëndimor mirëpresin synimin e Komisionit për të zhvilluar diskutime, në kuadër të Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit, me secilin prej tyre, në lidhje me kërkesat se si të shtyhen këto çështje përpara konkretisht.”⁴

Kosova në Samitin e Selanikut u përfaqësua përmes UNMIK-ut. Megjithatë, ndonëse deklarata përfundimtare premtonte perspektivën e liberalizimit të vizave për të gjithë qytetarët e vendeve në fjalë, zhvillimet e mëpastajme tregojnë se BE kishte dështuar të qartësonte se përparimi i Kosovës në këtë aspekt varet nga statusi i

¹ Vendimi nr. 03/63, Qeveria e Republikës së Kosovës, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_63-te_te_Qeverise_2009.pdf

² Vendimi për miratimin e Panit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave me Bashkimin Evropian, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimete_e_Mbledhjes_se_88_te_te_Qeverise_2009.pdf

³ Vendimi për themelimin e Grupit Punues koordinues për liberalizimin e vizave, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/vendimi_per_grupin_shqip.pdf

⁴ EU-Western Balkans Summit – Declaration, pika 7 (theksimet në *Italic* – të shtuara),

http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accession_process/how_does_a_country_join_the_eu/sap/thessaloniki_summit_en.htm

saj i ardhshëm politik, kjo përkundër faktit se mbështeste zbatimin e plotë të politikës së UNMIK-ut të ‘Standardeve para Statusit’⁵. Nga ana tjetër, as perspektiva e lehtësimit e as ajo e liberalizimit të vizave nuk përmendet në kuadër të dokumenteve bilaterale Kosovë - BE. Në këtë kontekst, dokumenti i dalë nga takimi i dytë i ‘Mekanizmit Përcjellës të procesit të Stabilizim-Asociimit’ përmban vetëm pesë rekomandime në kuadër të fushës së drejtësisë dhe punëve të brendshme.⁶ Kjo tregon se udhëheqja më e lartë politike BE-së kishte dështuar t’i ofronte Kosovës ndonjë perspektivë të prekshme për liberalizimin e vizave, për shkak të mungesës së konsensusit në mes të gjitha shteteve anëtare për të përfshirë Kosovën në këtë (kjo e fundit për shkak të mosnjohjes së saj nga pesë Shtetet Anëtare), pa parajgykuar statusin e saj politik.

Vendimet e mëpastajme politike të BE-së tregojnë se nuk kishte vullnet politik në mesin e Shteteve Anëtare madje as për të filluar formësimin e konsensusit politik mbi nevojën e mos-përjashtimit të Kosovës, apo për të ngritur këtë çështje si të rëndësishme për të ardhmen e afërt duke udhëzuar Komisionin që të orientonte dhe kanalizonte instrumentin e ardhshëm (‘Mekanizmin Përcjellës të Stabilizim-Asociimit’) kah perspektiva e liberalizimit të vizave. Kështu, Strategjia e Zgjerimit e vitit 2005 (e para ku përfshihen të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor) shprehimisht vlerëson përparimin e secilit vend të rajonit, përveç Kosovës, në përmbushjen e kriterëve për fillimin e procesit të liberalizimit të vizave, duke e lidhur atë me ri-pranimin dhe lehtësimin e vizave - “Përparimi në arritjen e marrëveshjeve për ri-pranim dhe lehtësim të vizave do të paraqesë shenjë të përkushtimit të ndërsjellë për bashkëpunim të mëtejshëm drejtësi, liri dhe siguri”⁷, kurse kur i referohet Kosovës askund nuk përmendet perspektiva dhe asnjë parakusht për fillimin e mundshëm të procesit të liberalizimit të vizave.

Më 13 nëntor 2006, qeveritë e Shteteve Anëtare, të mbledhur në kuadër të Këshillit të BE-së për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, autorizuan Komisionin Evropian për të filluar negociatat për marrëveshje të ri-pranimit me Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë, kurse kjo kishte ndodhur me Shqipërinë më 28 nëntor 2002.⁸ Më pas, më 2007 BE filloi vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale në këtë fushë, me vullnet politik të shprehur qartazi dhe në mënyrë të prekshme e transparente drejt liberalizimit të vizave, me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë. Më 18 shtator 2007 u nënshkruan marrëveshjet për lehtësimin e vizave dhe për riatdhesim në mes të këtyre pesë vendeve dhe shteteve anëtare të BE-së.⁹ Përmes këtyre marrëveshjeve mundësohej lehtësimi i procedurave për marrjen e vizave Schengen (në veçanti për ato kategori të shtetasve të këtyre vendeve që kanë më së shumti nevojë për të udhëtuar në BE), si dhe vendoseshin rregullat dhe procedurat për menaxhimin e migrimit legal dhe luftimin e atij ilegal. Ky proces formal në fushën e ri-pranimit përfundoi më 8 nëntor 2007, me miratimin e vendimit të Këshillit të BE-së për këto marrëveshje.¹⁰

Në vijimësi të procesit të filluar me nënshkrimin e marrëveshjeve për lehtësimin e vizave dhe për riatdhesim në mes të Shteteve Anëtare të BE-së në njërin anë, dhe nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovinën, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia, nga ana tjetër, në nëntor 2007 publikohet Strategjia vjetore e Zgjerimit 2007-2008 për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, përmes së cilës KE propozon fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave me këto vende. Pasi përmbledh përparimin e arritur dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve për lehtësimin e vizave dhe atyre për riatdhesim, ajo propozon fillimin e dialogut me secilin shtet në përcaktimin e udhërrëfyesve për liberalizimin e plotë të vizave, si dhe liston fushat me prioritet në kuadër të këtij procesi përgatitor: menaxhimi kufijve, siguria e dokumenteve, dhe luftimi i krimit të organizuar.¹¹ Sa i përket Kosovës, kjo komunikatë fokusohet kryesisht në stabilitetin politik në kontekstin e procesit të negociatave për statusin e saj politik, kurse në kuadër të fushës së drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përmendet se i mungon një regjim vizash ndaj vendeve të tjera, pastaj se puna në futjen në përdorim të pasaportave biometrike duhet të kryhet në përputhje me standardet evropiane. Në fushën e ri-pranimit, nënvizohet nevoja për avancimin e përgatitjeve në pritje të numrit në rritje të të kthyerve, në

⁵ Poaty, pika 5

⁶ *Second Meeting of the Kosovo SAp Tracking Mechanism*, fq. 3,

http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/plenary_stm_02_conclusions_en.pdf

⁷ *Communication from the Commission – 2005 Enlargement Strategy Paper*, [http://eur-](http://eur-lex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexplus!prod!CELEXnumdoc&lg=en&numdoc=505DC0561)

[lex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexplus!prod!CELEXnumdoc&lg=en&numdoc=505DC0561](http://eur-lex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexplus!prod!CELEXnumdoc&lg=en&numdoc=505DC0561)

⁸ *Readmission agreements with the countries of the Western Balkans*, http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/14562_en.htm

⁹ *Signature of nine agreements on visa facilitation and readmission between the European Community and all Western Balkans Countries by Vice President Franco Frattini and by the Portuguese Minister of Interior, Rui Carlos Pereira*,

<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/07/1350&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en#fn1>

¹⁰ *Readmission agreements with the countries of the Western Balkans*, http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/14562_en.htm

¹¹ *Communication from the Commission to the European Parliament and the Council: Enlargement Strategy and Main Challenges 2007 – 2008*, fq. 13,

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/strategy_paper_en.pdf

përputhje me standardet evropiane, pasi që nuk ekzistojnë ligje, strategji apo plane veprimi, e as mjete buxhetore¹² për të përballuar fluksin e pritur në rritje të tyre.

Siç mund të vihet re, përderisa me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor fushat në lidhje me liberalizimin e vizave ishin përvijuar si prioritete politike, sa i përket Kosovës prioriteti kryesor politik mbetej ruajtja e stabilitetit në kontekstin e përcaktimit të statusit të saj. Nga ana tjetër, para vitit 2008 Kosova nuk kishte kapacitete për të hyrë në çfarëdo marrëdhëniesh politike me ndonjë entitet tjetër politik, madje institucionet vendore nuk i kishin akoma të gjitha kompetencat në fushat përkatëse. Megjithatë, përkundër faktit se dialogu teknik e politik në mes të Qeverisë së Kosovës promovohet si diçka që tashmë u kishte hapur sigurt rrugën qytetarëve të saj drejt Evropës, duket se asnjëra palë nuk kishin bërë ndonjë përpjekje që të paktën të fillonin formësimin e një lloj konsensusi mbi parapërgatitjet që duheshin bërë e as se si të arriheshin ato. Nga kjo mund të vihet re një dështim në nivelin politik, pasi që nuk kishte ndonjë ide të qartë se si të lehtësohej puna në kapërcimin e barrierave, përfshirë atyre politike (të cilat po injoroheshin vazhdimisht për të dalë në pah vetëm në vitin 2009), për të arritur deri te fillimi i dialogut.

Kjo edhe përkundër faktit se gjatë tërë vitit 2007 po zhvilloheshin negociatat për statusin e Kosovës, me përfshirje vendimmarrëse të BE-së. Përderisa Qeveria e Kosovës qartazi po tregohej e ngathët në përcaktimin e prioriteteve me qëllim të përgatitjeve për këtë proces, gjë që më vonë do të justifikohet kryesisht me faktin se në atë kohë po zhvilloheshin negociatat për statusin politik të vendit. Nga ana tjetër, BE-ja qartazi e kishte më me prioritet politik definimin e Misionit të saj EULEX, si instrument të politikës së saj të jashtme në formësim e sipër, sesa që të udhëzonte autoritetet vendore në parapërgatitje për fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave. Kjo tregon një mungesë të plotë koherence të qasjes së BE-së në raport me Kosovën dhe mungesë koordinimi në mes të akterëve brenda saj, si dhe sa u përket politikave e niveleve të operimit, qoftë në mes të nivelit politik dhe atij teknik, qoftë brendapërbrenda secilit nivel ndarazi.

As në kuadër të të ashtuquajturit 'Mekanizëm Përcjellës të Stabilizim-Asociimit' nuk përmendej fusha e riatdhesimit dhe ri-integrimit të të riatdhesuarve, të cilën shtetet fqinje e kishin adresuar para se të merrnin udhërrëfyesit. Sipas konkluzioneve të takimit përkatës në mes të KE-së dhe Qeverisë së Kosovës¹³, ishin prekur vetëm dy çështje tejet të përgjithshme që pothuaj nuk lidhen fare me këtë fushë: kontrolli i lëvizjes së personave përgjatë kufijve dhe mungesa e një ligji për azil. Kjo tregon se dialogu vazhdonte të bazohej në interesat vetëm të BE-së, e jo në interesa të përbashkëta, ngase BE vetëm ishte e interesuar vetëm që të pamundësonte dhe parandalonte daljen e qytetarëve të Kosovës drejt territorit të saj dhe të shtetasve të vendeve të treta të cilët potencialisht do të mund të shfrytëzonin Kosovën si rrugë transit për të hyrë në territorin e saj. Edhe Raporti i Progresit 2007¹⁴, ndonëse kishte përmendur probleme specifike në fusha të ndryshme të ndërlidhura me liberalizimin e vizave, vazhdonte të mbetej në të njëjtat korniza disbalanci në mes të palëve të përfshira në *kuazi*-procesin e stabilizim-asociimit. Pra, ndonëse autoritetet vendore duhej ta kishin të qartë se ishim larg standardeve evropiane sa i përket regjimit të vizave për vendet e treta, dokumenteve të identifikimit e udhëtimit, migracionit, riatdhesimit, të gjitha këto çështje vetëm numëroheshin një nga një, por nuk përmendej, për shembull, riatdhesimi dhe ri-integrimi i personave të riatdhesuar si 'prioritetet e prioriteteve' dhe si kriteri më i vështirë për t'u përmbushur, e mos të flasim për ide më strategjike dhe qartësi se në çfarë drejtimi do të ndihmonte adresimi i problemeve të identifikuara në përgatitjen e vendit për fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave.

As në kuadër të Partneritetit Evropian 2008¹⁵ nuk ishte arritur ndonjë përparim në përcaktimin e prioriteteve. Në fushat relevante për liberalizimin e vizave, prioritetet e përcaktuara Kosovës në kuadër të këtij dokumenti strategjik vështirë se mund të quhen strategjike: ato fokusoheshin në çështje si përmirësimi i kontrollit kufitar dhe institucioneve përgjegjëse për këtë, forcimi i bashkëpunimit të këtyre institucioneve me ato të shteteve fqinje, strehimi i azilkërkuesve, si dhe një ligj e dokumente strategjike politikash për migracion, të cilat duhej të adresonin në veçanti riatdhesimin dhe ri-integrimin e të riatdhesuarve. Së pari, këtu mungonte një kornizë

¹² Poaty, fq. 55

¹³ *Thirteenth Meeting of the Stabilisation and Association Process Tracking Mechanism*, fq. 7,

http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/plenary_stm_13_conclusions_en.pdf

¹⁴ *Kosovo 2007 Progress Report*, fq. 45, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/kosovo_progress_reports_en.pdf

¹⁵ *Council Decision of 18 February 2008 on the principles, priorities and conditions contained in the European Partnership with Serbia including Kosovo as defined by United Nations Security Council Resolution 1244 of 10 June 1999 and repealing Decision 2006/56/EC*, http://eur-lex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexplus!prod!DocNumber&lg=en&type_doc=Decision&an_doc=2008&nu_doc=213

strategjike prioriteteve e cila do të udhëzonte efektshëm autoritetet kosovare që të merrnin drejtimin e duhur drejt parapërgatitjeve për fillimin e dialogut. Së dyti, nuk kishe asnjë prioritet politike, e as rekomandime mbi vendimet politike për të adresuar barrierat politike. Përkundrazi, këto barrierat po injoroheshin nga të dyja palët e përfshira në ‘mekanizmin përcjellës’. Kjo tregon se ishte e pamundur arritja e të gjitha reformave të kërkuara duke punuar në një kornizë kaq kaotike dhe pa drejtim strategjik. Kjo edhe për faktin se, së treti, këto prioritete ishte e pamundur të vendoseshin në një kornizë realiste dhe të arritshme kohore. Së katërti, këto prioritete nuk adresonin në mënyrë të efektshme problemin e ‘pronësisë vendore’, për faktin se ishin aq të gjëra, jo-kohore dhe rrjedhimisht më tepër ç’orientuese për të dyja palët sesa që të kanalizonin parapërgatitjet drejt nisjes së dialogut, bazuar në vlerësim të BE-së i cili të ishte sistematik, serioz dhe i drejtë. Së fundi, dhe jo vetëm kaq, e tërë kjo tregon në thelb mungesë transparence, si nga ana e BE-së ashtu edhe e institucioneve vendore, ndaj publikut të gjerë, pasi që më tepër po krijonin mjegull sesa qartësi mbi çfarë kritere duhej përmbushur dhe si.

Përgjatë tri viteve në vijim (2008 - 2010), Kosova dhe BE vijuan të fokusonin marrëdhëniet e tyre në kuadër të dialogut politik dhe teknik të stabilizim-asociimit, gjatë së cilës periudhë nuk u arrit ndonjë përparim drejt fillimit të dialogut formal për liberalizimin e vizave, as nuk u harmonizua agjenda e dialogut, politik e teknik, të stabilizim-asociimit me atë të liberalizimit të vizave. Rrjedhimisht, asnjëra palë nuk dolën me ndonjë ide, e as shënuan ndonjë parapërgatitje substanciale, për të adresuar pengesat politike të cilat po pengonin fillimin e këtij dialogu formal. Ndonëse autoritetet kosovare, pas miratimit të udhërrëfyesit të njëanshëm dhe Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave, i raportonin KE-së në kontekst të implementimit të tij, KE nuk bëri ndonjë vlerësim sistematik të këtyre parapërgatitjeve në kontekstin e fillimit të mundshëm të dialogut për liberalizimin e vizave, a as i shfrytëzoi ato për të dalë me një ‘qasje të strukturuar’, siç kishte rekomanduar vetë në Studimin për Kosovën, edhe pse qe obliguar nga Këshilli i BE-së që të bënte këtë.

Në mesin e vitit 2008 u prekën vetëm dy çështje: përkrahja financiare e BE-së në fushën e sigurisë së dokumenteve dhe rëndësia e hartimit të një strategjie për luftimin e krimit të organizuar.¹⁶ Në fund të këtij viti nga dialogu politik dolën një numër rekomandimesh konkrete për disa çështje të tjera relevante dhe parakusht për liberalizimin e vizave. Aspektet legjislative kishin të bënin me luftimin e korrupsionit, kontrollin e pasurive të zyrtarëve të lartë publikë, parandalimin e konfliktit të interesit, Gjykatën Kushtetuese, sanksionet penale, luftimin e shpëlarjes së parave dhe administrimin e pasurive të konfiskuara. Reformat institucionale lidheshin me themelimin një agjencie për administrimin e pasurive të konfiskuara dhe një bordi ekzekutiv për menaxhimin e integruar të kufirit, kurse dokumentet e politikave preknin strategjitë kundër korrupsionit, kundër narkotikëve, për luftimin e krimit të organizuar, kundër terrorizmit, dhe një plan veprimi për menaxhimin e integruar të kufirit.¹⁷

Në fazën e fundit para kalimit nga i ashtuquajtura ‘Mekanizëm Përcjellës’ në Dialogun e Stabilizim-Asociimit, përveç disa rekomandimeve të papërmbushura gjatë vitit paraprak, reformat legjislative që u rekomanduan preknin të gjitha aspekte e politikave kundër korrupsionit, financimin e partive politike, çështjet penale, reformën e gjyqësorit, mjekësinë ligjore, ekzekutimin e sanksioneve penale, mbrojtjen e dëshmitarëve, dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Më tej, dokumentet e politikave të rekomanduara kishin preknin politikat kundër korrupsionit, shërbimin korrektues, luftimin e krimit të organizuar, parandalimin dhe reduktimin e krimit, migrimin dhe mbledhjen e armëve të lehta. Në nivel të reformave institucionale, rekomandimet preknin koordinimin e politikave kundër korrupsionit (me synim fuqizimin e rolit të prokurorisë), kompletimin e Këshillit Gjyqësor, bartjen e kompetencave për disiplinimin e gjyqtarëve nga Ministra e Drejtësisë te Këshilli Gjyqësor dhe reformimin e Policisë Kufitare.¹⁸

Nxjerrja e Studimit për Kosovën nuk solli ndonjë përparim drejt fillimit të dialogut për liberalizimin e vizave. Pasi numëron tri fushat ku duheshin fokusuar reformat (riatdhësimi dhe ri-integrimi i të riatdhesuarve, siguria e kufijve dhe siguria e dokumenteve), ai premtonte një ‘perspektivë të liberalizimit eventual të vizave kur të jenë kryer

¹⁶ 14th Meeting of the Stabilisation-Association Process Tracking Mechanism – Conclusions, fq. 8, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/plenary_stm_14_conclusions_en.pdf

¹⁷ 15th Meeting of the Stabilisation-Association Process Tracking Mechanism – Conclusions, fq. 3, 5, 9 – 10, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/plenary_stm_15_conclusions_en.pdf

¹⁸ 16th Meeting of the Stabilisation-Association Process Tracking Mechanism – Final Conclusions, fq. 4, 6, 11 – 12, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/plenary_stm_16_conclusions_en.pdf

reformat e domosdoshme'.¹⁹ Përveç që nuk qartëson nëse këto reforma duhet të kryheshin para fillimit të dialogut ose deri në përfundim të tij (siç ishte rasti me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor)²⁰, KE në këtë që dokument (i cili gjatë hartimit të tij, quhej 'studim') nuk kishte prezantuar ndonjë studim serioz të gjendjes aktuale në këto fusha, e rrjedhimisht as kishte dhënë ndonjë ide se si do të dukej faza e zhvillimeve kur BE do të pranonte se përparimi do të ishte i kënaqshëm për të filluar dialogun. Në anën tjetër, në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit, gjatë periudhës 2010 - 2011 vijuan të mbuloheshin po të njëjtat fusha dhe çështje që ishin mbuluar deri atëherë. Rekomandimet kryesore në kuadër të tyre përfshijnë përfundimin e reformës së gjyqësorit, përfundimin e procesit të emërimit dhe ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kompletimin e rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të planifikuar, fuqizimin e pavarësisë së prokurorive, monitorimin dhe vlerësimin sistematik të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, zgjidhjen e rasteve të trashëguara dhe grumbulluara nëpër gjykata, përmirësimin e bashkëpunimit në mes të agjencive të zbatimit të ligjit gjyqësorit, zhvillimin e një baze të dhënash të personave të dënuar dhe rasteve të përmbuar, përgjegjësinë e personave juridikë, mbrojtjen e informatorëve (në kuadër të politikave kundër korrupsionit), bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, ri-integrimin e personave të riadhesuar, forcimin e kapaciteteve të Policisë për hetime kriminale, dizajnimin e pasaportave biometrike, etj.²¹

Autoritetet përgjegjëse për Kosovën në KE filluan vetëm nga fillimi i vitit 2009 ta trajtojnë çështjen e përjashtimit të Kosovës, kryesisht në nivel të parimit të mos-diskriminimit, dhe atë vetëm pas presionit të ushtruar që nga viti 2009 (nga autoritetet shtetërore, mediat dhe shoqëria civile në Kosovë, pastaj nga disa organizata të shoqërisë civile që veprojnë në nivel të BE-së [kryesisht Iniciativa Evropiane për Stabilitet, ESI], dhe disa anëtarë të Parlamentit Evropian që mbulonin Kosovën dhe procesin e liberalizimit të vizave me rajonin e Ballkanit Perëndimor). Krejt çka premtinin këto autoritete të KE-së fillimisht ishte që të përpiqeshin të gjenin një zgjidhje për të filluar dialogun e vizave me Kosovën, pa marrë parasysh qëndrimet e shteteve anëtare ndaj statusit politik të saj, siç pretendon edhe tani KE që të fillojë këtë proces. Rrjedhimisht, as dialogu teknik në mes të BE-së dhe Kosovës nuk përmbante asnjë rekomandim apo kërkesë të orientuar shprehimisht kah procesi i përmbushjes së kriterëve për liberalizimin e vizave. Ky lloj qëndrimi i vagullt politik i BE-së ndaj Kosovës u reflektua edhe nga 'Studimi për Kosovën' i fundvitit 2009. Aty KE fillimisht shpreh nevojën që qytetarët e Kosovës të përfitojnë më tepër nga dobitë që sjell përafrimi me BE-në, përfshirë mundësinë e udhëtimit pa viza në BE, për të vazhduar me reformat që Kosova duhet të kryejë me prioritet në këtë drejtim. Prioriteti i parë i vënë ka të bëjë me ri-integrimin e personave të riadhesuar dhe çështje të ndërlidhura të migrimit, respektivisht nevojën për të përshtatur legjislacionin, forcuar kapacitetet administrative për të proceduar kërkesat për ri-pranim dhe zbatuar një strategji të efektshme ri-integrimi. Dy fushat e tjera me prioritet ishte ajo e sigurisë së kufijve dhe ajo e menaxhimit të regjistrave civilë dhe lëshimit të dokumenteve personale.²²

Kjo komunikatë më tej vazhdon duke tentuar të propozojë njëfarë perspektive për të arritur deri te perspektiva e mundshme e fillimit të dialogut për liberalizimin e vizave, të cilën e prezanton në një formë më komplekse se asnjëherë më parë në raste të ngjashme: "Komisioni propozon që të ecet përpara me një qasje të strukturuar për të sjellë qytetarët e Kosovës më afër BE-së përmes një dialogu vizash, me perspektivë eventuale të liberalizimit të vizave, kur do të jenë ndërmarrë reformat e domosdoshme. Bazuar në një vlerësim të plotë, Komisioni propozon hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për të udhëzuar përpjekjet e Kosovës për të përmbushur kërkesat e BE-së për liberalizimin e vizave. Kjo strategji do të vendosë standarde për të matur përparimin e Kosovës në kontekstin e një dialogu vizash, dhe do t'i prezantohet Këshillit për informim."²³ Në dhjetor 2009, Ministrat e Jashtëm të BE-së, të mbledhur në Këshillin e BE-së për Çështje të Përgjithshme, përsërisin të njëjtën retorikë, ku ripërsëritet se 'edhe Kosova duhet të përfitojë nga perspektiva e liberalizimit të mundshëm të vizave, sapo të jenë përmbushur të gjitha kushtet' dhe ftohet KE që të 'ecë përpara me një qasje të strukturuar për të sjellë popullin e

¹⁹ *Communication from the Commission to the European Parliament and the Council: Kosovo – Fulfilling its European Perspective*, fq. 6, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf

²⁰ *Isolation Confirmed. How the EU is undermining its interests in Kosovo*, fq. 5, http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_119.pdf

²¹ *1st Plenary of the Stabilisation Association Process Dialogue – Conclusions*, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/plenary_of_the_stabilisation_association_process_dialogue_en.pdf

²² *2nd Plenary of the Stabilisation Association Process Dialogue – Conclusions*, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/111116sap_dialogue_plenary_conclusions_2011_final.pdf

²³ *Communication from the Commission to the European Parliament and the Council: Kosovo – Fulfilling its European Perspective*, fq. 5 – 6, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf

²³ Poaty, fq. 6

Kosovës më afër BE-së.²⁴ Së pari, për t'u ikur pengesave të mundshme politike të Shteteve Anëtare në Këshill, në vend të një dialogu për liberalizim vizash, KE i propozon Këshillit një 'qasje të strukturuar' për përafrim të Kosovës me BE-në përmes një dialogu vizash, të bazuar në një dokument politikash (i cili për shtetet fqinje të Kosovës quhej 'udhërrëfyes', por për shkaqe të pengesave politike, për Kosovën do të mund të emërtohej sidoqoftë ndryshe).

Së dyti, Këshillit i propozohet diçka të cilën ai nuk obligohet shprehimisht që ta miratojë, pasi që në vijim thuhet se një strategji gjithëpërfshirëse për udhëzimin e këtij procesi do t'i paraqitej Këshillit vetëm për informim. Kjo demonstroi mungesën e vullnetit politik të BE-së për t'i ofruar Kosovës një perspektivë të qartë për fillimin e një procesi i cili është teknik në substancë por rezultati i të cilit (heqja e regjimit të vizave për shtetasit e Kosovës) ka rëndësi kyçe politike dhe paraqet një nga qëllimet kryesore të ekzistencës së BE-së si 'eksportuese të stabilitetit'. Më tej, kjo rrezikon të relativizojë vlefshmërinë e kondicionalitetit si instrument i zgjerimit të BE-së, duke mundësuar shtimin e vazhdueshëm të kushteve brenda kushteve deri te arritja e rezultatit përfundimtar. Pasoja më negative në rastin e Kosovës është forcimi i vazhdueshëm i mospajtimeve brenda vetë BE-së (në veçanti te pesë shtetet e saj anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën), duke e vështirësuar politikisht procesin e mëtejshëm të integritetit të Kosovës në BE, rrjedhimisht gjithashtu duke e dëshmuar vetë BE-në të paaftë për të zbatuar dhe mbrojtur vlefshmërinë e zgjerimit si një ndër politikat më të suksesshme të BE-së dhe të evropianizimit si proces të emancipimit dhe zhvillimit të shoqërive dhe përhapjes së vlerave shoqërore dhe politike evropiane.

Së treti, në vend që për këtë të vendosë Këshilli i BE-së për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, dhe që pastaj Komisionarja për Drejtësi dhe Punë të Brendshme dhe Komisionari i Zgjerimit të dalin me propozime procedim të mëtejshëm²⁵, çështja vazhdon të sillet në rrafshin politik. Kështu, fakti që Këshilli për Çështje të Përgjithshme del me qëndrim në thelb të njëjtë me qëndrimin paraprak të KE-së tregon se BE faktikisht kishte vendosur për të mos vendosur asgjë. E kjo e fundit demonstroi një kontradiktë në mes të deklarimeve publike të BE-së që ta trajtojë Kosovën barabartë, pa marrë parasysh statusin e saj politik, dhe vendimeve të institucioneve të saj, në bazë të të cilave ajo dhe qytetarët e saj vazhdojnë të diskriminohen në raport me fqinjët e tyre. Së fundi, por jo vetëm kaq, në këtë propozim BE nxjerr një formulim akoma më të vagullt, një 'perspektivë eventuale', në vend se të propozojë fazat dhe hapat konkretë, njëjtë sikur për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, si dhe afate realiste dhe transparente brenda të cilave do të përmbusheshin këto kritere. Kjo pasi që, në mungesë të një liste gjithëpërfshirëse dhe shteruese kriteresh dhe kushtesh, rrezikohet dukshëm kredibiliteti i BE-së në mesin e qytetarëve të Kosovës, dhe rrjedhimisht rrezikohet rritja e euroskepticizmit në mesin e tyre.

Edhe pas mbi dy vjetësh pas publikimit të 'Studimit për Kosovën', KE akoma nuk ka dalë me asnjë dokument që dëshmon ndonjë qasje të strukturuar të tij për të sjellë Kosovën më afër BE-së. Në mungesë të vullnetit politik për ta vendosur këtë qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, e cila do t'i udhëzonte Kosovën në ecjen sa drejt fillimit të dialogut për liberalizimin e vizave, madje edhe të një Partneriteti të ri, Evropian, gjatë tërë kësaj kohe nga BE kanë ardhur vetëm deklaratat politike. Ato kryesisht janë fokusuar në fushën e ri-integritetit të personave të riatdhesuar, ndërkohë që ka pasur shumë pak fokus në fusha të tjera. Madje edhe vetë BE në terren ka dëshmuar përkeqësim sa i përket një qasjeje të strukturuar, pasi që akoma nuk ka arritur të reformojë përfaqësimin e saj në Prishtinë, në përputhje me Traktatin e Lisbonës, kurse i tërë aktiviteti i saj politik në raport me Kosovën është fokusuar në dialogun Prishtinë - Beograd. Madje edhe sa i përket riatdhesimit dhe ri-integritetit të personave të riatdhesuar, BE nuk ka bërë asnjë përpjekje politike për të përsheptuar nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale të riatdhesimit në mes të Kosovës dhe shteteve të saj anëtare veç e veç.

Në nivel teknik, në mungesë të kësaj qasjeje të strukturuar, është shënuar përparim i kufizuar në fusha të tjera shumë të rëndësishme për liberalizimin e vizave, siç janë luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit (kjo edhe për shkak të performancës tejet të dobët të EULEX-it), reformimin e strukturave institucionale të sistemit gjyqësor dhe përsheptimin e punës së tyre në zgjidhjen e rasteve të pazgjidhura. Më tej, gjithashtu janë shënuar pak përparime sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile dhe bashkëpunimit ndërkombëtar policor, përkundër premtimeve të EULEX-it për të ndihmuar në këto fusha. Gjendja mbetet edhe më

²⁴ 2984th Council meeting – General Affairs Brussels, 7 December 2009: Press Release,

<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=PRES/09/370&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>

²⁵ The Schengen White List Project: The EU decision-making process, <http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=354>

e vështirë sa i përket kapitullit të të drejtave fundamentale të njeriut, në të cilën fushë strukturat institucionale, në të gjitha hallkat dhe nivelet, mbeten jo-efiçente, të pa-reformuara dhe pa kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar kornizën ligjore në fuqi dhe garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive të njeriut.

II. Përmbajtja e udhërrëfyesve për liberalizimin e vizave

Ndonëse Kosova deri diku dallon nga vendet fqinje sa i përket kornizës ligjore dhe politike që ndërlidhet me zhvillimin dhe zbatimin e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, përmbajtja e udhërrëfyesit të njëanshëm është e njëjtë me atë të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Pjesa hyrëse e këtij udhërrëfyesi fillon me qëndrimin politik zyrtar të saj, se Republika e Kosovës do që të avancojë drejt liberalizimit të vizave duke përmbushur të gjitha kriteret, marrë parasysh faktin se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nisur ose janë duke finalizuar këtë proces, dhe se BE, duke mos i dhënë Kosovës një udhërrëfyes, po rrezikonte izolimin e saj, me rrezik të destabilizimit të saj dhe të rajonit.²⁶ Më tej, kur bëhet fjalë për aspekte formale të përcaktuara nga ana e BE-së, e cila është pala përcaktuese në këtë proces, përmenden katër elemente:

1. Konkluzionet e 28 janarit 2008 të Këshillit për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme, përmes të cilëve mirëpritet synimi i KE-së për të nisur dialogun për viza me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shprehet gatishmëria e tij për të diskutuar më tej me to, me synim përcaktimin e udhërrëfyesve të hollësishëm për secilin vend, për të ecur përpara drejt liberalizimit të vizave;
2. Përkushtimi politik i BE-së për liberalizimin e vizave afat-shkurta për qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor si pjesë e agjendës së Selanikut, miratuar nga Këshilli më 2003;
3. Arritja nga ana e të gjitha vendeve të rajonit e marrëveshjeve për ri-pranim të Komunitetit;
4. Lirimi nga viza i të gjithë qytetarëve të BE-së nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.²⁷

Në fund të kësaj pjese përmenden dy parakushtet për fillimin e dialogut: marrëveshja për ri-pranim dhe ajo për lehtësimin e vizave. Ndonëse nuk i ka nënshkruar asnjërin, për shkak të mosnjohjes së 'pesëshes' së BE-së, Kosova merr në mënyrë të njëanshme obligimet që dalin nga instrumentet e BE-së, përfshirë zëvendësimin e marrëveshjeve bilaterale me një marrëveshje të vetme, nënshkrimin e 'protokolleve implementuese' me Shtetet Anëtare të BE-së, si dhe ndërmarrjen e masave të duhura për të siguruar implementim efektiv të një marrëveshjeje të tillë dhe miratimin e masave për të siguruar që infrastruktura e duhur të jetë ndërtuar.²⁸

Sa u përket objektivave të përgjithshme në kuadër të secilit bllok, Udhërrëfyesi i njëanshëm i miratuar nga Qeveria e Kosovës ka strukturë dhe përmbajtje identike me udhërrëfyesit zyrtarë të Shqipërisë dhe Maqedonisë, pra është i ndarë në katër blloqe: siguria e dokumenteve; migrimi ilegal, përfshirë ri-pranimin; rendi dhe siguria publike; dhe marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore.

Në kuadër të bllokut të **sigurisë së dokumenteve**, kriteret që kërkohet të përmbushen janë të përmbledhur në kuadër të gjashtë objektivave të përgjithshme:

1. Lëshimi i dokumenteve biometrike të udhëtimit, të cilat të jenë të lexueshme me makinë, në përputhje me standardet e ICAO-së dhe KE-së, dhe futja gradualisht në përdorim e të dhënave biometrike;
2. Miratimi dhe implementimi i masave adekuate administrative për të siguruar integritetin dhe sigurinë e procesit të personalizimit dhe shpërndarjes;
3. Krijimi i programeve trajnuese dhe miratimi i kodeve etike kundër korrupsionit dhe targetimi (me trajnime) i zyrtarëve të secilit autoriteti publik që merret me viza apo pasaporta;
4. Raportimi në bazën e të dhënave të Interpol-it/LASP mbi pasaportat e humbura dhe të vjedhura;
5. Sigurimi i nivelit të lartë të sigurisë së dokumenteve shtesë dhe kartelave të identifikimit, dhe përcaktimi i procedurave strikte që kanë të bëjnë me lëshimin e tyre.

²⁶ Udhërrëfyes i Liberalizimit të Vizave me Bashkimin Evropian, fq. 1 <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Roadmap%20ALB.pdf>

²⁷ Poaty, fq. 2

²⁸ Poaty, fq. 3 – 4

Sa i përket bllokut të dytë, atij për *migrimin ilegal, përfshirë ri-pranimin*, kriteret janë të përmbledhur në kuadër të 13 objektivave të përgjithshme, të ndara në katër nën-bloqe: menaxhimi i kufirit, politikat e azilit, përgjegjësitë e bartësit dhe menaxhimi i migracionit:

Menaxhimi i kufijve:

1. Miratimi dhe implementimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufijve Kombëtarë, me përgjegjësi të definuara në mënyrë të qartë të menaxhimit të kufijve;
2. Miratimi dhe implementimi i legjislacionit që rregullon lëvizjen e personave nëpër kufijtë e jashtëm, si dhe legjislacionit mbi organizimin e autoriteteve kufitare dhe funksionet e tyre, në pajtueshmëri me Strategjinë e përditësuar të Menaxhimit të Integruar të Kufijve Kombëtarë;
3. Ndërmarrja e masave të nevojshme buxhetore dhe të tjera administrative për të siguruar infrastrukturë efikase, pajisje, teknologji të TI-ës në kufijtë e jashtëm;
4. Krijimi i programeve të trajnimit dhe miratimi i kodeve etike kundër korrupsionit, dhe ofrimi i trajnimeve rojeve kufitare, doganave dhe zyrtarëve të tjerë të përfshirë në menaxhimin e kufijve;
5. Arritja e një marrëveshjeje pune me FRONTEX-in;

Përgjegjësitë e bartësit

6. Miratimi dhe implementimi i legjislacionit mbi përgjegjësinë e bartësit duke përcaktimi i sanksioneve;

Politikat e azilit

7. Implementimi i legjislacionit në fushën e azilit, në përputhje me standardet ndërkombëtare (Konventën e Gjenevës të vitit 1951 me Protokollin e Nju Jork-ut), si dhe kornizën ligjore dhe standardet e BE-së;
8. Sigurimi i infrastrukturës adekuate dhe forcimi i organeve përgjegjëse, në veçanti në fushën e procedurave të azilit dhe pranimit të azilkërkuesve.

Menaxhimi i migracionit

9. Krijimi dhe fillimi i aplikimit të një mekanizmi për monitorimin e rrjedhave të migracionit, definimi i profilit të migracionit për Republikën e Kosovës, përditësimi i tij i rregullt me të dhëna si për migrimin ilegal ashtu edhe atë legal, dhe krijimi i organeve përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi llojet dhe rrjedhat e migracionit;
10. Miratimi dhe implementimi i politikave të integritit për migrantët, përfshirë mbështetjen e qëndrueshme financiare dhe sociale;
11. Definimi dhe zbatimi i një metodologjie për zbulimin brenda vendit, dhe ndërmarrja e masave për përmirësimin e kapacitetit për hetimin, e rasteve të migrimit të organizuar dhe të mundësuar ilegal;
12. Implementimi i ligjit mbi pranimin dhe qëndrimin e shtetasve të vendeve të treta, duke definuar të drejtat dhe obligimet për personat në fjalë (përfshirë anëtarët e familjeve të shtetasve të vendit të tretë);
13. Sigurimi i dëbimit efektiv të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ilegalisht në territorin e vendit.

Kriteret në kuadër të bllokut të tretë, për *rendin dhe sigurinë publike*, janë të përmbledhur në kuadër të 16 objektivave të përgjithshme, të ndara në katër nën-bloqe: parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, bashkëpunimi juridik në çështjet penale, bashkëpunimi në zbatimin e ligjit, dhe mbrojtja e të dhënave personale.

Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit

1. Miratimi dhe implementimi i Strategjisë për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit (në veçanti aspektet ndër kufitare) duke miratuar dhe implementuar planet e parapara të veprimit përfshirë kornizën kohore dhe resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;
2. Miratimi dhe implementimi i Strategjisë për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore duke miratuar dhe implementuar një Plan të Veprimit, përfshirë kornizën kohore dhe resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare;
3. Miratimi dhe implementimi i një strategjie kombëtare për parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, përfshirë masat e nevojshme legjislative bazuar në analizat e legjislacionit ekzistues; implementimi i legjislacionit përkatës mbi konfiskimin e aseteve të kriminelëve (përfshirë dispozitat që adresojnë aspekte ndër-kufitare);

4. Miratimi dhe implementimi i një strategjie dhe një plani kombëtar të veprimit kundër drogës; mundësimi i qasjes së informatave mbi konfiskimet e drogës dhe personave të përfshirë në pikëkalime kufitare; zhvillimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave me organet relevante ndërkombëtare në fushën e drogës;
5. Miratimi dhe implementimi i një strategjie gjithëpërfshirëse anti-korrupsion, dhe miratimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit; miratimi dhe implementimi i masave për forcimin e kapacitetit institucional, koordinimi ndër-sektorial dhe sigurimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për përpjekjet anti-korrupsion;
6. Implementimi i konventave relevante të KB-ës dhe të Këshillit të Evropës, si dhe rekomandimeve të GRECO dhe standardeve të tjera ndërkombëtare në fushat e renditura më lartë dhe i atyre për luftimin e terrorizmit.

Bashkëpunimi juridik në çështjet penale

7. Implementimi i konventave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale (në veçanti Konventat e Këshillit të Evropës);
8. Ndërmarrja e masave me synim përmirësimin e efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale të gjykatësve dhe prokurorëve me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me vendet në rajon;
9. Zhvillimi i marrëdhënieve të punës me Eurojust-in, kryesisht përmes pikës së kontaktit në Eurojust;
10. Përmirësimi i shkëmbimit të informatave në mes të agjencive kombëtare përmes krijimit të mekanizmave adekuatë dhe efektivë për koordinim;
11. Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal të shërbimeve për zbatim të ligjit dhe implementimi i marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale operacionale të bashkëpunimit, përfshirë këmbimin e informatave përkatëse me kohë me autoritetet kompetente për zbatimin e ligjit të Shteteve Anëtare;
12. Përmirësimi i kapaciteteve operacionale dhe speciale hetimore të shërbimeve të zbatimit të ligjit për trajtim (prekje) në mënyrë më efektive të krimit ndër-kufitar;
13. Ndërmarrja e hapave të nevojshëm për përgatitjen e arritjes së një marrëveshjeje operacionale bashkëpunimi me Europol-in, me theks special në dispozitat për mbrojtjen e të dhënave.

Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit

14. Ndërmarrja e hapave të nevojshëm për të siguruar efikasitetin në bashkëpunimin për zbatimin e ligjit në mes agjencive kombëtare relevante - posaçërisht rojeve kufitare, policisë, zyrtarëve doganor përmes bashkëpunimit të plotë ndër-sektorial në fushën e shkëmbimit të inteligjencës, si dhe bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore;

Mbrojtja e të dhënave

15. Miratimi i legjislacionit të nevojshëm mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe implementimin e dispozitave të tij, përfshirë krijimin e një autoriteti mbikëqyrës të pavarur për mbrojtjen e të dhënave;
16. Ratifikimi dhe implementimi i konventave përkatëse ndërkombëtare, si Protokollin Shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Procesimin Automatik të të Dhënave Personale.

Kriteret në kuadër të bllokut të katërt, për ***marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore***, janë të përmbledhur në kuadër të 8 objektivave të përgjithshme, të ndara në tre nën-bloqe: liria e lëvizjes së shtetasve, kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit, dhe të drejtat e qytetarëve, përfshirë mbrojtjen e minoriteteve.

Liria e lëvizjes së shtetasve

1. Siguron se liria e lëvizjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës nuk u nënshtrohet kufizimeve të pajustificueshme, përfshirë masat e natyrës diskriminuese, bazuar në çfarëdo baze të tillë si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tipareve gjenetike, gjuhës, religjionit apo besimit, mendimit politik apo ndonjë tjetër, anëtarë i një pakice kombëtare, pronës, lindjes, paaftësisë fizike, moshës apo orientimit seksual.

Kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit

2. Sigurimi i qasjes së plotë dhe efektive në dokumentet e udhëtimit dhe të identitetit për të gjithë qytetarët e Kosovës përfshirë gratë, fëmijët, njerëzit me paaftësi, njerëzit që i përkasin minoriteteve dhe grupeve tjera të ndjeshme;
3. Siguron qasje të plotë dhe efektive për dokumentet e identitetit për IDP dhe refugjatë;

Të drejtat e qytetarëve, përfshirë mbrojtjen e minoriteteve

4. Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për të siguruar mbrojtje efektive kundër diskriminimit;
5. Specifikimi i kushteve dhe rrethanave për fitimin e nënshtetësisë së Kosovës;
6. Sigurimi i hetimit të incidenteve të motivuara etnikisht nga ana e zyrtarëve të zbatimit të ligjit në fushën e lirisë së lëvizjes, përfshirë rastet e kur cak mund të jenë pjesëtarë të minoriteteve;
7. Sigurimi i zbatimit të dispozitave kushtetuese mbi mbrojtjen e minoriteteve;
8. Implementimi i politikave përkatëse lidhur me minoritetet, përfshirë romët.

III. Përmbajtja e Planit të Veprimit të Kosovës për Liberalizimin e Vizave me Bashkimin Evropian

Plani i Veprimit për Liberalizimin e Vizave (PVLV) 2009 - 2011²⁹ reflektonte strukturën e Udhërrëfyesit, dhe pjesa substanciale e tij përbëhej nga shtatë kapituj:

1. Siguria e dokumenteve / kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit;
2. Bashkëpunimi i agjencive në zbatimin e ligjit/parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit, drogave, korrupsionit dhe trafikimit me qenie njerëzore;
3. Bashkëpunimi gjyqësor në fushën e çështjeve penale;
4. Politikat e azilit;
5. Menaxhimi i migrimit;
6. Menaxhimi i kufijve; dhe
7. Mbrojtja e të dhënave personale.

I tërë plani përmbante rreth 150 veprime specifike të planifikuara për t'u ndërmarrë me qëllim të përmbushjes së kriterëve të kërkuara nga udhërrëfyesi, përfshirë legjislacion dhe dokumente politikash, marrëveshje ndërkombëtare, ndërtim institucionesh dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndër-institucional (si brenda ashtu edhe jashtë vendit), trajnime dhe infrastrukturë teknike dhe zbatim të drejtpërdrejtë.

Sa i përket **sigurisë së dokumenteve**, PVLV parashihte kompletimin e kornizës ligjore (përfshirë marrëveshjet me Interpolin që ndërlidhen me këtë fushë), ngritjen e kapaciteteve institucionale e teknike (TË Agjencisë së Regjistrimit Civil si institucion i specializuar për këtë fushë, një studim fizibiliteti, si dhe lëshimin e dokumenteve biometrike. Megjithatë, në kuadër të tij nuk ishte paraparë ndonjë strategji, të paktën afatmesme, e zhvillimit institucional të ARC-së (si agjenci të sapo-themeluar), as ndonjë program trajnime të vazhdueshëm për zyrtarët që do të merren me prodhimin dhe lëshimin e pasaportave biometrike, e as ndonjë kod etike i cili do të siguronte integritetin e tërë procesit (pra parandalimin dhe adresimin e keqpërdorimeve të mundshme, përfshirë korrupsionin).

Në kuadër të kapitullit të **bashkëpunimit të agjencive në zbatimin e ligjit**, PVLV parashihte plotësimin e ligjeve për: pengimin e shpëlarjes së parave, mbrojtjen e dëshmitarëve, të kodit të rishikuar penal dhe atij të procedurës penale, kundër korrupsionit, kundër terrorizmit, kundër krimit kompjuterik, për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e kredibilitetit të të dhënave, si dhe të ligjeve për gjykatat dhe prokuroritë publike. Në nivel të dokumenteve të politikave, specifikohet miratimi i Strategjia dhe PV Kundër korrupsionit 2009-2011, si dhe zbatimi i Strategjive dhe PV-ve Kundër Krimit të Organizuar, Kundër Drogave dhe Kundër Terrorizmit, por sa u përket këtyre tri të fundit nuk është vendosur ndonjë aktivitet me prioritet i cili do të siguronte implementimin e tyre

²⁹ Plani i Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit të Qeverisë së Kosovës për Liberalizimin e Vizave me Bashkimin Evropian, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/VisaLiberalizationActionPlan_ALB.pdf

përgjatë tërë ciklit të politikave, përfshirë vlerësimin adekuat dhe të rregullt të implementimit të tyre dhe rishikimin periodik të tyre.

Sa i përket ndërtimit të institucioneve, aty parashiheshin një numër aktiviteteve për zhvillimin dhe funksionalizimin e strukturë së reformuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me fokus në themelimin e një departamenti qendror të politikave. Ai gjithashtu parashihte themelimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe të një qendre për rehabilitim social të të varurve nga substancat narkotike. Ky plan gjithashtu parashihte fillimin e negociatave për anëtarësimin e Njësisë së ardhshme të Inteligjencës Financiare në 'Egmont Group'-in e Njësisë të Inteligjencës Financiare, vendosjen e mekanizmave të bashkëpunimit në mes të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Prokurorisë së Shtetit dhe Gjykatave. Në kontekstin e zhvillimit të institucioneve gjithashtu ka aktivitete që synojnë rritjen e kapaciteteve humane të institucioneve përkatëse (policisë, doganës dhe institucioneve gjyqësore) për luftimin e krimit të organizuar, krimeve financiare, trafikimit të qenieve njerëzore dhe të narkotikëve. Kur jemi te implementimi, ai përmban vetëm aktivitete të formuluara përgjithësisht për të siguruar parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve të këtij lloj krimi.

Kjo e fundit duket qartazi e porealizueshme marrë parasysh se plani nuk parasheh zhvillimin e një programi për mbrojtje të dëshmitarëve (të të gjitha llojeve të krimeve) dhe të kapaciteteve institucionale për implementimin e tij. Nga ana tjetër, është e qartë se reformimi dhe zhvillimi institucional i MPB-së, e në veçanti kapacitetet e saj për zhvillim të politikave (gjë që vlen për të gjitha institucionet e tjera të përfshira në përmbushjen e kritereve), paraqesin parakushte për fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave, e rrjedhimisht nuk duhet të figurojnë në një dokument nacional për këtë qëllim. Përveç këtyre, ky plan nuk adresonte të gjitha dimensionet e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke filluar nga zhvillimi i politikave e deri te alokimi i resurseve të mjaftueshme, të gjitha këto në masë të theksuar për shkak të mungesës së një qasjeje sistematike në implementimin e strategjive të ndryshme të hartuara me qëllim të parandalimit dhe luftimit të llojeve të ndryshme të krimit dhe korrupsionit, bazuar në vlerësim real të nevojave dhe kërcënimeve të rrezikshmërisë. Më tej, PVLV nuk parashihte miratimin dhe implementimin e një strategjie për parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, e as të legjislationit zbatues kundër këtyre krimeve (përfshirë atë për konfiskimin e pasurive kriminale dhe të dispozitave përkatëse me implikime ndër-kufitare), pasi që mungonte një ligj përkatës.

Në nivel teknik, ky plan gjithashtu ishte i mangët sa i përket zhvillimit të kapaciteteve humane e teknike për të mundësuar qasjen e integruar të agjencive të menaxhimit të kufijve në informata që kanë të bëjnë me luftimin e trafikimit të narkotikëve. Në fakt, zhvillimi dhe ndërlidhja e bazave adekuate të të dhënave të agjencive të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit mbetet problematike tashmë për disa vite. Kjo çështje duhet të adresohet me prioritet, dhe në mënyrë të qëndrueshme e sistematike, pasi që është e domosdoshme për të siguruar vlerësimin adekuat të rrezikshmërisë që vjen nga krimet, në veçanti ato ndërkufitare, si dhe për luftimin e parandalimin adekuat të tij dhe sigurimin e raportimit të duhur. Pa këto elemente është e pamundur të vlerësohet shkalla e zbatimit të ligjit dhe politikave të zhvilluara, e as vlerësimi i performancës së agjencive të zbatimit të ligjit e të sistemit gjyqësor dhe i impaktit në reduktimin e krimeve dhe korrupsionit. Në fushën a anti-korrupsionit, PVLV nuk kishte identifikuar ndonjë çështje me prioritet për të forcuar kapacitetet institucionale, koordinimit ndër-sektorial dhe alokuar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, e as çështjet e zbatimit të instrumenteve e standardeve relevante ndërkombëtare (të OKB-ës, Këshillit të Evropës, GRECO-së, në fushën e krimeve financiare)] kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Kur jemi te kapitulli i tretë i PVLV, përkatësisht *bashkëpunimi juridik në fushën e çështjeve penale*, aty parashihej arritja e marrëveshjeve për transferimin e të pandehurve dhe të dënuarave me shtetet fqinje, nëntë vende të BE-së (Austri, Belgjikë, Danimarkë, Finlandë, Francë, Gjermani, Itali, Slloveni dhe Suedi), dy shtete jashtë BE-së (Norvegji dhe Zvicër) dhe me Turqinë, si dhe zhvillimi i mëtejshëm institucional dhe ngritja e kapaciteteve humane të strukturave përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë që janë përgjegjëse për politikën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale. Kur jemi te kjo e fundit, duhet vënë re se një gjë e tillë kërkon vlerësim adekuat të nevojave, për faktin se bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale ka qenë deri më 2008 nën kompetencë të plotë të UNMIK-ut, por që gjithashtu kërkon bashkëpunim plotësisht funksional me

gjqësorin dhe funksionalitet të plotë të këtij të fundit, në veçanti për shkak të numrit të madh të kërkesave të trashëguara nga UNMIK-u (rreth 18,000 sosh³⁰).

Në anën tjetër, PVLV nuk përmbante aktivitete për të siguruar arritjen e objektivave të udhërrëfyesit për zbatimin e konventave ndërkombëtare në këtë fushë (në veçanti të atyre të Këshillit të Evropës). Përmirësimin e efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale të gjykatësve dhe prokurorëve me homologët e tyre në Shtetet Anëtare të BE-së dhe në vendet fqinje, vendosjen e marrëdhënieve të punës me Eurojust-in dhe Eurpol-in, përmirësimin e shkëmbimit të informatave dhe koordinimit në mes të agjencive kombëtare të sundimit të ligjit dhe gjyqësorit dhe me agjencitë e institucionet homologe të shteteve anëtare të BE-së, si dhe ngritjen e kapaciteteve operacionale dhe speciale hetimore të shërbimeve të zbatimit të ligjit për luftimin efikas të krimit ndër-kufitar. Më tej, këtij plani veprimi gjithashtu i mungonte komponenti i bashkëpunimit efikas për zbatimin e ligjit në mes agjencive përkatëse kombëtare dhe me gjyqësorin, e në veçanti në shkëmbimin e inteligjencës.

Në fushën e **politikave të azilit**, PVLV kishte paraparë kryesisht masa për reforma dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe menaxhuese për kontrollin e migrimit, me fokus te azilkërkuetit, përkatësisht themelimin e një qendre të përhershme pranimit për azilkërkuetit, rekrutimin e stafit, si dhe miratimin dhe përditësimin e rregullt të një plani trajnimi për këtë fushë. Sidoqoftë, sa i përket legjislacionit, mungesa e zbatimit sistematik të legjislacionit kornizë përgjatë tërë ciklit të politikave të azilit (nga kërkesa për azil e deri te mekanizmi i ankesës dhe masave të mundshme gjyqësore) shtron nevojën e zhvillimit të procedurave precize që do të vendosnin rigorozitet në sistemin e vendimmarrjes procedural në të gjitha hallkat e politikave të azilit, përfshirë monitorim strikt dhe sistem sanksionesh procedurale. Kjo gjithashtu kërkon që, bazuar në monitorim strikt, të zhvillohen politika me objektiv të saktë të cilat do të adresonin sistematikisht mangësitë e gjetura në tërë sistemin, duke filluar nga politikat për ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve përkatëse, me qëllim që të sigurohet që çdo rast të trajtohet në mënyrë adekuate, dhe në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet e BE-së. Edhe sa i përket infrastrukturës në fushën e azilit, PVLV parashihte masa kryesisht të përgjithësuara, të cilat duket se nuk bazohen në ndonjë vlerësim sistematik të fluksit dhe të resurseve në dispozicion, dhe rrjedhimisht as janë të ndërlidhur sa duhet me aspektin e zhvillimit të legjislacionit, politikave dhe kapaciteteve institucionale përkatëse për zhvillimin e politikave dhe zbatimin e procedurave.

Më tej, kur jemi te **menaxhimi i migrimit**, aty parashihej nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale të ri-pranimit me shtetet anëtare të BE-së, duke u dhënë prioritet atyre nga të cilat kërkohet kthimi i një numri më të madh shtetasish kosovarë, por gjithashtu edhe me shtetet fqinje të cilat janë pjesë e 'listës së bardhë Schengen'. Aty gjithashtu parashiheshin masa për vendosjen e një regjimi vizash për vende të treta, themelimin e misioneve diplomatike dhe atyre konsullore të Republikës së Kosovës, reforma institucionale (me fokus kryesisht në qartësimin e kompetencave në mes të Policisë dhe autoriteteve civile, MPB-së, në këtë fushë), hartimin dhe zbatimin e kodeve të etikës kundër korrupsionit për stafin që do të merret me lëshimin e vizave dhe lejeve të qëndrimit, zhvillimin e bazave të të dhënave për lëshimin e vizave dhe monitorimin e migracionit, dhe ofrimi i trajnimeve zyrtarëve përkatës.

Edhe sa i përket menaxhimit të migracionit, ky plan nuk përmbante veprime specifike dhe të matshme, në veçanti sa i përket ndërtimit të institucioneve dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre, përfshirë bazat e të dhënave dhe qarkullimit të informatave në mes të Policisë dhe MPB-së si dy institucionet kryesore përgjegjëse. Përveç kësaj, duket se kishte nevojë që prioritetet të vendoseshin në mënyrë më të realizueshme sa u përket aktiviteteve në kuadër të këtij kapitulli, pasi që pa vendosjen e regjimit të vizave për vendet e treta, zhvillimin e profilit të migracionit për Republikën e Kosovës dhe zhvillimin e një baze të integruar të dhënash (e cila do të përfshinte të gjitha kategoritë e migrantëve: të riatdhesuarit, të ri-pranuarit nga vendet e treta dhe të huajt) janë parakushte themelore për të siguruar planifikim adekuat, dhe të bazuar në nevoja, të trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera të ndërlidhura për implementim të përditshëm të politikave të migracionit. Më tej, pa një vlerësim të bazuar në indikatorë të fluksit të hyrjes dhe daljes së migrantëve në dhe nga territori i vendit, dhe nevojave që rrjedhin nga ky fluks, vështirë se mund të ketë planifikim dhe shpenzim të efektshëm dhe efikas të mjeteve financiare të alokuara.

³⁰ Ministria e Drejtësisë, Divizioni për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, <http://www.md-ks.org/?page=1,46>

Kjo vlen posaçërisht sa i përket ri-integrimit të personave të riatdhesuar, në kuadër të së cilës fushë gjithashtu vërehet harmonizim i pamjaftueshëm në mes të marrëveshjeve bilaterale të riatdhesimit dhe dimensionit të integrimit të personave të riatdhesuar, pasi që pa të dhëna të sakta dhe të plota mbi të riatdhesuarit, bëhet tejet i vështirë planifikimi i resurseve institucionale dhe i masave për ngritjen e kapaciteteve të tyre për të menaxhuar fluksin dhe për të siguruar integrimin e qëndrueshëm të tyre përmes mbështetjes së qëndrueshme financiare dhe sociale. E njëjta vlen edhe për ri-pranimin dhe transferimin e shtetasve të tretë në vendet e tyre të origjinës, dhe dëbimin efektiv të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ilegalisht në territorin e vendit. Parakusht për të siguruar këtë është edhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale të ri-pranimit (gjë që është edhe politikisht e vështirë) me të gjitha vendet e BE-së dhe ato fqinje të 'Listës së Bardhë Schengen', dhe shkëmbimi i rregullt i informatave në fushën e menaxhimit të migrimit.

Sa i përket *menaxhimit të kufijve*, PVLV parashihte aktivitete për zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (kryesisht me fokus në përditësimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Policisë së Kosovës dhe vendosjen e bashkëpunimit me FRONTEX-in - Agjencinë e BE-së të specializuar për siguri të kufijve). Një tjetër tërësi aktiviteteve fokusoheshin në nënshkrimin e marrëveshjeve për asistencë të ndërsjellë doganore me 19 shtete, shumica dërrmuese shtete anëtare të BE-së dhe vende fqinje, dhe përpjekje për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganave. Në anën tjetër, Udhërrëfyesi kërkonte aktivitete për përkufizimin e qartë të përgjegjësive të agjencive të menaxhimit të kufirit (Policisë, Doganës dhe shërbimeve fito-sanitare), me qëllim të implementimit të duhur të Strategjisë dhe PV për Menaxhimin e Integruar të Kufirit. Rrjedhimisht, do të kishte qenë e udhës që PVLV të përmbante edhe një numër aktiviteteve me prioritet që do të qonin drejt qartësisë të këtyre përgjegjësive dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale të të tria institucioneve në nivel më të barabartë (në veçanti sa u përket shërbimeve fito-sanitare, të cilat mbeten me kapacitete më të dobëta në krahasim me dy të tjerat), por edhe aktivitete të tjera që do të adresonin pengesat në zbatimin e Strategjisë në fjalë.

Më tej, PVLV nuk përmbante asnjë veprim sa i përket hartimit të legjislacionit dhe të procedurave më precize për të siguruar qartësimin e këtyre përgjegjësive, e madje as ndonjë veprim sa i përket demarkacionit të kufijve me vendet fqinje dhe transferimit të përgjegjësive për kontrollin e linjës së gjelbër dhe të kaltër të kufirit nga KFOR-i te Policia Kufitare. Kjo e fundit gjithashtu do të duhej të ndërlihej më mirë, sa u përket afateve kohore, me aspekte të zhvillimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore e teknike për kontroll kufitar, integrimin e bazave të të dhënave për kontroll kufitar, dhe vendosjes së bashkëpunimit operacional me agjencitë homologe të shteteve fqinje. Një aspekt tjetër që nuk mbulohet në PV është ndërlidhja më e mirë e konceptit të menaxhimit të integruar të kufirit me aspekte të luftimit të llojeve të ndryshme të krimit të organizuar dhe atij ndër-kufitar, si dhe shfrytëzimi më i mirë i këtij koncepti për të parandaluar dhe luftuar këto lloje krimesh.

Në fund, *mbrojtja e të dhënave personale* mbetet fusha më e pazhvilluar dhe më problematike në kuadër të PVLV, kryesisht për shkak se në kohën e hartimit të tij Kosova akoma nuk kishte themeluar agjencinë e specializuar për mbrojtjen e të dhënave personale. Prandaj ky plan parashihte veprime krejt fillestare, që kanë të bëjnë me themelimin dhe funksionalizimin e kësaj agjencie, hartimin e një plani trajnimesh dhe një kodi të etikës kundër korrupsionit. Në anën tjetër, në kuadër të PVLV-së, megjithatë, do të mund të përcaktoheshin veprime përmes të cilave institucionet e ndryshme që mbajnë të dhëna personale të qytetarëve të fillonin përgatitjet për të kryer veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Tani që Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është themeluar, mbetet shumë për të bërë në kompletimin e legjislacionit zbatues, ratifikimin e konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale, funksionalizimin e plotë të agjencisë dhe fillimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi nga të gjitha institucionet relevante.

Dy komponentë të Udhërrëfyesit, *lëvizja e lirë e shtetasve* dhe *të drejtat e qytetarëve, përfshirë mbrojtjen e minoriteteve*, nuk kanë qenë të reflektuar në kuadër të Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave me Bashkimin Evropian, e as institucionet përgjegjëse nuk kanë qenë të përfshirë efektshëm në punën e grupit punues përkatës.³¹

³¹ Vendimi për themelimin e Grupit Punues ndërmintor përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e të gjitha aktiviteteve në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës për implementimin e Planit të Veprimit për procesin e Liberalizimit të Vizave me Bashkimin Evropian (GPLV), http://www.mpb-ks.org/repository/docs/vendimi_per_grupin_shqip.pdf

IV. Implementimi i udhërrëfyesve për liberalizimin e vizave

Gjatë periudhës 2009 - 2011, Kosova ka shënuar arritje të konsiderueshme në arritjen e objektivave të vendosur në Udhërrëfyesin e njëanshëm për Liberalizimin e Vizave me BE-në. Gjatë kësaj periudhe është implementuar pjesa më e madhe e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave 2009 - 2011.

Sa i përket **Bllokut I**, të *sigurisë së dokumenteve*, Kosova aktualisht gjendet në fazën fillestare të prodhimit të pasaportave biometrike. Prodhimi i pasaportave biometrike ka filluar më 1 nëntor 2011³², bazuar në studimin përkatës të fizibilitetit, të përfunduar më herët gjatë vitit 2011, dhe pas fazës testuese, të filluar në fillim të korrikut. Para kësaj është avancuar i tërë legjislacioni kornizë dhe ai zbatues në këtë fushë (me fokus në aspektet digjitale dhe biometrike të sigurisë së dokumenteve personale), kah mesi i vitit 2011.³³ Përveç kësaj, gjatë vitit 2009 dhe fillimit të vitit 2010 është kryer reforma institucionale që ka rezultuar në themelimin dhe funksionalizimin e Agjencisë për Regjistrim Civil³⁴, ndërkohë që janë ngritur kapacitetet njerëzore dhe teknike të Zyrave Komunale të Gjendjes Civile dhe atyre për Regjistrim Civil. Pas kësaj, MPB, në bashkëpunim me EULEX-in kanë kryer një vlerësim të hollësishëm të gjendjes së të gjitha zyrave që merren me prodhimin dhe lëshimin e dokumenteve personale, e cili ka mbuluar 255 zyra të tilla në tërë vendin.³⁵ Përmes këtij vlerësimi, përveç që janë identifikuar problemet në hollësi dhe është krijuar një praktikë e vlerësimit periodik të kësaj fushe, gjithashtu është kontribuar në rritjen e besueshmërisë në tërë sistemin e sigurisë së dokumenteve. Më tej, në korrik 2011 ka përfunduar procesi i skenimit dhe digjitalizimit të regjistrave civilë, i filluar në tetor 2010. ARC gjithashtu ka zhvilluar Planin e saj të Punës 2011 - 2015.³⁶ Ajo çka mbetet të adresohet është vendosja e bashkëpunimit teknik me konsullatat e shteteve anëtare të BE-së në Prishtinë, pastaj ofrimi i trajnimeve për konsullatat e Republikës së Kosovës në shtetet anëtare (para fillimit të lëshimit të dokumenteve të tilla nga to). Më tej, bashkëpunimi me Interpolin, me qëllim të raportimit në bazën e tij të të dhënave mbi pasaportat e humbura dhe të vjedhura (LASP) akoma nuk është vendosur, nuk ka filluar prodhimi i letërnjoftimeve biometrike, e nuk duket që kanë hyrë në fuqi kodet e etikës kundër korrupsionit.³⁷

Sa i përket *Shqipërisë*, sipas vlerësimit të fundit të KE-së para marrjes së vendimit për ta bërë atë pjesë të 'Listës së Bardhë Schengen' (maj 2010), numri i pasaportave biometrike të lëshuara ka qenë 497,000, me tipare të sigurisë në përputhje me standardet e ICO-së dhe BE-së. Edhe sistemi i prodhimit, personalizimit dhe shpërndarjes së pasaportave biometrike ishte vlerësuar si plotësisht funksional dhe efikas, stafi përkatës trajnohej në mënyrë adekuate, ishte arritur vendosja e mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimeve, siguria e prodhimit dhe ruajtjes së dokumenteve të tjera personale, dhe secili shtetas posedonte numër të përhershëm të letërnjoftimit.³⁸ Sa i përket *Maqedonisë*, sipas vlerësimit të fundit të KE-së para marrjes së vendimit për ta bërë atë pjesë të 'Listës së Bardhë Schengen' (maj 2009), janë lëshuar 417,000 pasaporta biometrike, 330,000 letërnjoftime dhe 140,000 patentë shoferi, të gjitha me elemente sigurie në përputhje me standardet e ICAO-së dhe BE-së. Gjithashtu infrastruktura teknike e prodhimit, personalizimit dhe shpërndarjes së pasaportave biometrike ishte vlerësuar si plotësisht efikase dhe funksionale, ishte arritur siguria e prodhimit dhe ruajtjes së dokumenteve të tjera personale, dhe nuk kishte raportuar asnjë rast i korrupsionit.³⁹

³² Pasaportat e para biometrike, <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,482>

³³ Input to the Progress Report (September 2011), fq. 48, http://mei-ks.net/repository/docs/Input_to_EC_Progres_Report_September_2011.pdf

³⁴ Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 2, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

Agjencia për Regjistrim Civil, <http://www.mpb-ks.org/?page=1,130>

³⁵ Isolation Confirmed. How the EU is undermining its interests in Kosovo, fq. 11, http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_119.pdf

³⁶ Input to the Progress Report (September 2011), fq. 48, http://mei-ks.net/repository/docs/Input_to_EC_Progres_Report_September_2011.pdf

³⁷ Dokumentet personale, <http://www.mpb-ks.org/?page=1,118>

³⁸ Updated Assessment of the implementation by Albania of the roadmap for visa liberalisation – 19 April 2010, fq. 1,

<http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20Albania%20assessment%2019%20April%202010.pdf>

³⁹ Updated Assessment of the implementation by the former Yugoslav Republic of Macedonia of the roadmap for visa liberalisation – 18 May 2009, fq. 1, <http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20FYROM%20updated%20visa%20assessment%2018%20May.pdf>

Edhe sa i përket **Bloku II**, të *migrimit ilegal, përfshirë ri-pranimin* (ku hyjnë edhe menaxhimi i integruar i kufirit, çështjet e azilit dhe menaxhimi i migrimit), *Kosova* ka shënuar përpertime të dukshme. Në fushën e *menaxhimit të integruar të kufirit*, Përveç Ligjit për Menaxhimin dhe Kontrollin e Integruar të Kufirit Shtetëror, procedurave standarde operative, dhe Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (ky i fundit në fuqi që nga viti 2009), kapacitetet e Policisë Kufitare dhe të Doganës për të menaxhuar kontrollin kufitar janë të kënaqshme, ndërsa shërbimet fito-sanitare akoma kanë nevojë për të ngritur kapacitetet e tyre. Sa i përket infrastrukturës teknike, Përveç lidhjes së të gjitha pikave të kalimit kufitar në internet, edhe sistemi PISCES i kontrollimit të hyrje-daljeve është funksional në të gjitha pikat kufitare⁴⁰, ashtu si edhe Qendra Monitoruese e MIK-ut, e lokalizuar në Doganat e Kosovës, nga ku monitorohen pikat e kalimit të kufirit, përmes kamerave⁴¹, ndërsa infrastruktura fizike dhe teknike në pikëkalimet kufitare përmirësohet vazhdimisht. Në fund të prillit 2011, MPB ka nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi me ministritë homologe të Shqipërisë dhe Maqedonisë për kontroll të përbashkët të kufirit, kurse po atë vit Policia Kufitare ka marrë nga KFOR-i përgjegjësinë për mbikëqyrjen e vijës së gjelbër të kufirit me Maqedoninë dhe është bërë plani për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi (gjë që pritet të përfundojë gjatë pjesës së parë të këtij viti).

Më tej, në gusht 2011 është funksionalizuar Sistemi i Menaxhimit të Kufirit (BMS) në të gjitha pikëkalimet kufitare (përfshirë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës), gjë që po ndihmon në përmirësimin e shkëmbimit të informatave edhe për qëllime të hetimeve penale, ndërsa vlerësimi i rrezikut dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit kryhen në baza tremujore nga viti 2010,⁴² ndonëse Strategjia nuk është përditësuar asnjëherë. Përveç kësaj, në proces e sipër është zhvillimi i një Qendre Informacioni të Policisë së Kosovës, i cili do të ndihmojë në integrimin e të gjitha sistemeve ekzistuese të TI-së në një të vetëm. Më tej, Dogana e Kosovës deri më tani ka nënshkruar gjashtë marrëveshje për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë me shërbimet doganore të vendeve të tjera, kurse disa prej marrëveshjeve të tjera janë në fazën e negociimit. Gjithashtu është ratifikuar instrumenti për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganave, dhe i është dorëzuar kësaj organizate.⁴³

Në fushën e *azilit dhe të huajve*, Përveç ligjeve përkatëse, gjatë vitit 2010 kanë hyrë në fuqi aktet ligjore dhe procedurale për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt në pikëkalimet kufitare dhe nga misionet konsullore të Republikës së Kosovës, procedimin e kërkesave të azilkërkuësve, funksionimin e qendrës së azilkërkuësve, dokumentet e qëndrimit dhe udhëtimit për të huajt, dispozitat ndëshkuese të Ligjit për të Huajt, Komisionin Shqyrtues dhe Komisionin për Ankesa të të huajve, Gjithashtu këtë vit janë funksionalizuar komisionet përgjegjëse për refugjatë, shqyrtimin e kërkesave për azil, shqyrtimin e ankesave të të huajve për qëndrimin e përkohshëm, ndërprerjen dhe anulimin e lejes së qëndrimit të përkohshëm e urdhrin për largim, si dhe komisioni përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të të huajve për qëndrimin e përkohshëm dhe të përhershëm si dhe për refuzimin, ndërprerjen dhe anulimin e lejes së qëndrimit për të huajt. Në dhjetor 2009 është funksionalizuar Qendra e përkohshme për Azilkërkuës.⁴⁴ Gjithashtu në fund të vitit 2010 dhe në gusht 2011 janë zhvilluar fushata për informimin e azilkërkuësve dhe të huajve mbi të drejtat dhe obligimet e tyre.⁴⁵

Në fushën e *ri-pranimit dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar*, në gusht 2010 ka hyrë në fuqi Ligji për Ri-pranim, i cili përcakton procedurat e verifikimit dhe riatdhesimit të qytetarëve kosovarë dhe ri-pranimit të të huaj që kanë kaluar nga Kosova në shtetet e tjera. Gjithashtu Kosova deri më tani ka nënshkruar rreth 15 marrëveshje bilaterale të ri-pranimit me vendet anëtare të BE-së dhe me vendet fqinje që janë pjesë e 'Listës së Bardhë Schengen'. Përveç kësaj, këtë vit është hartuar Strategjia e rishikuar për Ri-integrimin e të Riatdhesuarve, është funksionalizuar Bordi Koordinues për Ri-integrim dhe themeluar Fondi i Qeverisë për Ri-integrimin e të Riatdhesuarve. Në vitin 2010 në këtë fond janë alokuar €0.5 milion, kurse në vitin 2011 rreth €3.4 milionë. Përveç

⁴⁰ Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 7, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

⁴¹ Input to the Progress Report (June 2010), fq. 143, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Integrimit Evropian, qershor 2010, Prishtinë

⁴² Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 7, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

⁴³ Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 8, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

Input to the Progress Report (September 2011), fq. 46 – 48, http://mei-ks.net/repository/docs/Input_to_EC_Progres_Report_September_2011.pdf

⁴⁴ Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 7, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

⁴⁵ Input to the Progress Report (September 2011), fq. 48, http://mei-ks.net/repository/docs/Input_to_EC_Progres_Report_September_2011.pdf

Zyrës për Ri-pranim në kuadër të MPB-së dhe Zyrës Pritëse në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, në nivelin lokal, Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete janë përgjegjëse për këtë fushë, bazuar në Rregulloren mbi Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete, të miratuar nga Qeveria në gusht 2010. Pas miratimit të kësaj rregulloreje janë ofruar trajnime të vazhdueshme për këto zyra mbi zbatimin e politikave për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, dhe ka kapacitete për trajnime të vazhdueshme, pasi që vitin e kaluar janë certifikuar 16 trajnerë për politikën e ri-integrimit të personave të riatdhesuar. Edhe sa i përket vlerësimit të kapaciteteve të Komunave për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, vlerësimi i vitit të kaluar ka ndihmuar që të krijohet një praktikë e dobishme që mund të shfrytëzohet në të ardhmen.⁴⁶ Pra, ndonëse Kosovës, ndryshe nga të gjithë fqinjët e saj, i ishte shtuar një parakusht i ri⁴⁷, ai i forcimit të kapaciteteve administrative për të proceduar kërkesat për ri-pranim dhe implementimit të një strategjie për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, kjo edhe më tej konsiderohej e pamjaftueshme për të filluar dialogun.

Në anën tjetër, sipas vlerësimit të KE-së, *Shqipëria* në fushën e *menaxhimit të integruar të kufirit* kishte vënë në fuqi tërë legjislacionin për zbatimin e plotë dhe efektiv të Ligjit për Kontrollimin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, dhe se Strategjia dhe PV për Menaxhimin e Integruar të Kufirit ishte rishikuar në nëntor 2009 dhe po zbatohet. Në nivel të institucioneve, raporti vlerëson se bashkëpunimi në mes të agjencive ishte forcuar dhe një Qendër Ndër-institucionale Operacionale Detare ishte bërë funksionale. Sa u përket resurseve njerëzore, vlerësohej se ishin forcuar dhe një program trajnime ishte zhvilluar, në bashkëpunim me FRONTX-in, kurse gjithashtu ishte përmirësuar dukshëm infrastruktura fizike dhe teknike nëpër pikëkalimet kufitare. Edhe në fushën e *azilit* thuhej se i tërë sistemi ishte funksional dhe se legjislacioni ishte avancuar dhe përafuar me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së. Në fushën e *menaxhimit të migrimit*, vlerësohej se një plan veprimi për zbatimin e Ligjit mbi të Huajt ishte zbatuar kënaqshëm. Në këtë raport gjithashtu vlerësohej se ishte vënë në funksion të plotë një Regjistër Kombëtar i të Huajve dhe se ishte forcuar zbulimi i migrantëve të parregullt brenda territorit të vendit, kurse ndërtimi i një qendre ndalimi ishte në finalizim e sipër. Së treti, ky raport i fundit para heqjes së vizave vlerëson se nevojiteshin përpjekje shtesë për të zbatuar një strategji për ri-integrimin e shtetasve të riatdhesuar, gjë që do të verifikohet në vazhdimësi.⁴⁸

Në vlerësimin shtesë për çështjet e hapura, të shtatorit 2010, Shqipëria ishte vlerësuar se kishte bërë përparim të mirë sa i përket Strategjisë për Ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010 - 2015, e cila përmbante edhe një plan veprimi. Kjo strategji kishte vendosur një mekanizëm gjithëpërfshirës për promovimin e ri-integrimit të të kthyerve, e cila mbulonte nevojat kryesore (regjistrimi civil, strehimi, arsimit dhe punësimi), ndërsa gjithashtu ishte siguruar bashkëpunimin efektiv ndër-ministor në ri-integrimin e të kthyerve. Aty gjithashtu shpjegohej se plani i veprimit kishte paraparë tri kategori masash, të cilat kishin të bënin me: kornizën ligjore, ngritjen e kapaciteteve, dhe ofrimin e informatave dhe asistencës për të siguruar ri-integrimin e të kthyerve. Në fund shpjegohej mekanizmi i monitorimit, i centralizuar në një komitet ndër-ministor të kryesuar nga Kryeministri, dhe që bazohej në raporte gjashtëmujore progresi që përgatiteshin nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta, ndërsa për periudhën në vijim sugjerohej raportimi i rregullt statistikor.⁴⁹ Siç mund të vërehet, ky raport nuk bën fjalë fare për ri-integrimin e qëndrueshëm të të kthyerve, madje as për të dhëna statistikore, gjë që KE dhe Shtetet Anëtare i kërkojnë Kosovës akoma pa iu dhënë udhërrëfyesi dhe pa filluar dialogu për liberalizimin e vizave.

Vlerësimi i ngjashëm me Shqipërinë ishte dhënë për *Maqedoninë*, e cila thuhej se kishte përmirësuar kornizën ligjore në fushën e *menaxhimit të integruar të kufijve*, duke siguruar pajtueshmërinë me standardet e BE-së, ndërsa zbatimi i Planit të Veprimit për këtë fushë kishte përfunduar, dhe se policia kufitare ishte e organizuar në pajtueshmëri me standardet e BE-së dhe ishte raportuar bashkëpunim i mirë në mes të agjencive. Sa u përket kapaciteteve institucionale, thuhej se stafi ishte profesional, ndërsa analiza e rrezikut duhej përmirësuar dhe se kërkohej vazhdim i trajnimeve në këtë fushë. Gjithashtu kërkoheshin përmirësime të infrastrukturës së pikëkalimeve kufitare, por duket kontradiktor vlerësimi pozitiv sa i përket bashkëpunimit me të gjitha vendet

⁴⁶ Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 6 – 7, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

⁴⁷ Isolation Confirmed. How the EU is undermining its interests in Kosovo, fq. 8, http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_119.pdf

⁴⁸ Updated Assessment of the implementation by Albania of the roadmap for visa liberalisation – 19 April 2010, fq. 6,

<http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20Albania%20assessment%2019%20April%202010.pdf>

⁴⁹ Assessment by the European Commission on the fulfilment of the open benchmarks by Albania and Bosnia – 14 September 2010, fq. 5,

<http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20Albania%20and%20Bosnia%20assessment%2014%20September%202010.pdf>

fquinje sa i përket çështjeve kufitare, përderisa kur bëhet fjalë për Kosovën kërkohet përmirësim i mëtejshëm i bashkëpunimit me vendet fqinje në këtë fushë. Më tej, në fushën e *azilit* vlerësohej se sistemi ishte funksional dhe efikas, me legjislacion në pajtueshmëri me standardet e BE-së, dhe se procedurat e ankesave dhe qendra e pritjes së azilkërkuësve ishin funksionale. Sa i përket *menaxhimit të migrimit*, jepej një vlerësim i ngjashëm me atë për Shqipërinë, përkatësisht se korniza e ligjore, e politikave dhe procedurat ishin vendosur, se duhej vazhduar me trajnime për të siguruar zbatimin efikas të tyre, ashtu sikurse edhe me zhvillimin e një baze të dhënash për të huajt dhe zbatimin e strategjisë për integrimin e refugjatëve dhe migrantëve. Në fund, thuhej se bashkëpunimi në mes të institucioneve të përfshira në luftimin e migrimit ilegal funksiononte pa probleme, dhe se procedurat e kthimit ishin efikase dhe në pajtueshmëri me standardet evropiane.⁵⁰

Në kuadër të **Bllokut III**, të **rendit dhe sigurisë publike**, **Kosova** deri më tani pothuajse ka kompletuar kornizën ligjore. Ligji për Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit është në fuqi nga shtatori 2010⁵¹, por akoma mungon një strategji dhe plan veprimi për këtë fushë. Më 2010 gjithashtu ka hyrë në fuqi Ligji për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara⁵² dhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁵³, kurse më 2011 Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.⁵⁴ Ligje të tjera në kuadër të këtij blloku, të miratuara më 2010 dhe 2011 përfshijnë Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, Ligjin mbi Aspektet Civile të Trafikimit të Fëmijëve, Ligjin mbi Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Shkelje Penale⁵⁵, Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik (*Cyber-crime*), Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligjin për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Kredibilitetit të të Dhënave, dhe tri ligje anti-korrupsion (Ligjin e amendamentuar për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë). Megjithatë, Kodi i ri Penal dhe ai i Procedurës Penale akoma mbeten në procedurë të hartimit.⁵⁶

Gjatë periudhës 2008 - 2009 ka miratuar një numër strategjish në fushën e luftimit të krimit dhe krimit të organizuar: Strategjinë dhe PV Kundër Krimit të Organizuar 2009 - 2012, Strategjinë dhe PV për Parandalimin e Krimit 2009 - 2012, Strategjinë Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2008 - 2011 (e rishikuar vitin e kaluar - tani mbulon periudhën 2012 - 2015), Strategjinë dhe PV Kundër Drogave 2009 - 2012, dhe Strategjinë dhe PV Kundër Terrorizmit.⁵⁷ Gjithashtu më 2009 është miratuar për herë të parë Strategjia dhe PV Kundër Korrupsionit 2009 - 2011, e cila rishikohet çdo vit (strategjia aktuale mbulon periudhën 2012 - 2016)⁵⁸. Sidoqoftë, sa i përket përmbajtjes, të gjitha këto strategji janë vështirë të zbatueshme së pari për shkakun se nuk bazohen në një sistem indikatorësh, e rrjedhimisht as rishikohen e buxhetoren në baza vjetore, e as raportohet rregullisht mbi zbatimin e tyre. E tërë kjo i bën edhe më pak transparente të arriturat e mundshme. Së dyti, mbeten probleme të theksuara në zbatimin e këtyre strategjive nga institucionet përkatëse. Zbatimi efektiv dhe adekuat i Strategjisë Kundër Korrupsionit pengohet për shkak të mungesës së vullnetit politik për të ndjekur dhe ndëshkuar këtë fenomen, në veçanti rastet e përmasave të mëdha, por edhe për shkak se mekanizmat e parandalimit, në veçanti brendapërbrenda institucioneve, vazhdojnë të mos japin rezultate. Kjo e fundit ndodh edhe për shkak të mungesës së rregullave procedurale dhe moszbatimit të duhur të legjislacionit dhe standardeve për llogaridhënie dhe transparencë të buxhetit shtetëror. Sa u përket strategjive të tjera të përmendura, ato nuk arrihet të zbatohen plotësisht dhe si duhet për shkak të sfidave më komplekse, por më themelore, duke filluar nga kapacitetet e pamjaftueshme të policisë dhe prokurorive për hetimin e krimeve, mungesa e bashkëpunimit të mjaftueshëm në mes të agjencive të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit, e deri te sfida tej-kufitare, që kanë të bëjnë me bashkëpunimin operacional të agjencive të zbatimit të ligjit me homologët e shteteve të tjera, në veçanti atyre

⁵⁰ Updated Assessment of the implementation by the former Yugoslav Republic of Macedonia of the roadmap for visa liberalisation – 18 May 2009, fq. 4, <http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20FYROM%20Updated%20visa%20assessment%2018%20May.pdf>

⁵¹ Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 3, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

Agjencia për Regjistrim Civil, <http://www.mpb-ks.org/?page=1,130>

⁵² Input to the Progress Report (June 2010), fq. 143, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Integritimit Evropian, qershor 2010, Prishtinë

⁵³ Kuvendi i Republikës së Kosovës: Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,465>

⁵⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës: Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,659>

⁵⁵ Kosovo 2011 Progress Report, fq. 11, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf

⁵⁶ Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 3, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

⁵⁷ Ministria e Punëve të Brendshme: Dokumentet Strategjike, <http://www.mpb-ks.org/?page=1,114>

⁵⁸ Agjencia Kundër Korrupsionit: Dokumente Politikash, <http://www.akk-ks.org/?cid=1,17>

fqinjë, bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështje penale, integrimin në nisma dhe organizata rajonale, evropiane e ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e krimit, e kështu me radhë.

Në nivelin e ndërtimit të institucioneve, më 2010 është themeluar Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara përkatëse, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e cila pothuajse është funksionalizuar plotësisht.⁵⁹ Sidoqoftë, ajo nuk menaxhon ndonjë pasuri domethënëse për shkak se akoma nuk është nxjerrë ndonjë vendim domethënës i gjykatave për konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të kundërligjshme. Më tej, si rezultat i reformimit të Policisë së Kosovës, në fillim të vitit 2010 është themeluar Njësia kundër Krimit të Organizuar⁶⁰ (në kuadër të Departamentit të Hetimeve⁶¹). Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, është krijuar Baza përkatëse e të Dhënave, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të institucioneve relevante për luftimin e këtij lloji krimi, si dhe janë instaluar numra telefonikë kujdestarë në pikëkalimet kufitare.⁶² Në qershor 2011 Kuvendi ka emëruar Këshillin Mbikëqyrës të Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me çka është themeluar kjo agjenci, e cila në gusht 2011 ka miratuar Rregulloren e Punës dhe organogramin e saj, si dhe planin e punës. Më tej, pas themelimit të saj më 2010, deri kah fundi i vitit 2011 ajo është kompletuar me staf, të cilët gjithashtu janë trajnuar. Gjithashtu janë mbajtur trajnime për stafin e Policisë së Kosovës përgjegjës për luftimin e trafikimit të narkotikëve, trafikimit me qenie njerëzore, hetimeve policore, dhe menaxhimin e pasurive të konfiskuara e të sekuestruara.⁶³

Sa u përket aspekteve të tjera që kërkojnë në kuadër të këtij blloku, sfidë mbetet nënshkrimi i konventave përkatëse të OKB-së, Këshillit të Evropës, dhe ato të GRECO-s, dhe zhvillimi i marrëdhënieve të punës me Europol-in dhe Eurojust-in. Këto probleme të ratifikimit të këtyre konventave dhe integritit në organizata rajonale e evropiane janë tejkualuar pjesërisht në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar përmes miratimit të ligjeve të sipërpërmendura në këtë fushë. Edhe në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, zhvillimet janë në fazën fillestare, prandaj ratifikimi dhe implementimi i konventave përkatëse ndërkombëtare, si Protokollin Shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Procesimin Automatik të të Dhënave Personale, mbetet për t'u adresuar. Kur jemi te përmirësimi i shkëmbimit të informatave në mes të agjencive kombëtare përmes krijimit të mekanizmave adekuatë dhe efektivë për koordinim, janë nënshkruar një numër memorandumesh bashkëpunimi në mes të agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve gjyqësore, por megjithatë gjyqësori akoma mbetet mbrapa në këtë aspekt, pasi që Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Lëndëve (SMIL) nuk është plotësisht funksional, ndërsa akoma nuk ka filluar zhvillimi i një baze të dhënash të personave të dënuar. Në anën tjetër, siç është shpjeguar më sipër Policia e Kosovës është në proces të integritit të të gjitha bazave të saj të të dhënave në një Sistem të Integruar Informativ, si dhe nga viti 2010 është duke implementuar Strategjinë e Policisë së Udhëhequr nga Inteligjenca⁶⁴, e cila adreson edhe aspektet e ngritjes së kapaciteteve për hetime policore, përfshirë ato për përmirësimin e qarkullimit të informatave.

Në anën tjetër, sipas vlerësimit të KE-së, **Shqipëria** kishte avancuar kornizën ligjore për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit me miratimin e ligjeve për konfiskimin e pasurive të përfituara përmes krimit të organizuar, ndihmën juridike reciproke dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, ndërsa strategjitë në të gjitha fushat e këtij blloku po zbatoheshin dhe përafrimi i kornizës ligjore me standardet evropiane dhe ndërkombëtare po përparonte. Kur flet për fusha specifike, vlerësimi tregon përmirësim të dukshëm të punës së agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve gjyqësore në përndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndonëse shkalla e dënimeve mbetet akoma e ulët. Me të njëjtat terma vlerësohet edhe shkëmbimi i informatave në mes të akterëve përgjegjës për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, hetimet e përbashkëta polic - gjyqësor, bazuar në konceptin e policisë së udhëhequr nga inteligjenca. Në fund të vlerësimit për këtë bllok, KE thekson se janë alokuar burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe se konfiskimi i pasurive të fituara përmes krimit të organizuar po vijonte me vendosmëri.⁶⁵

⁵⁹ Kosovo 2011 Progress Report, fq. 53, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf

⁶⁰ Raporti i Progresit mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 3, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Raporti%20Oper%20liberalizim%20te%20vizave.pdf>

⁶¹ Policia e Kosovës – Departamenti i Hetimeve, <http://www.kosovopolice.com/?page=1,30>

⁶² Input to the Progress Report (June 2010), fq. 146, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Integritit Evropian, qershor 2010, Prishtinë

⁶³ Input to the Progress Report (September 2011), fq. 48 – 50, http://mei-ks.net/repository/docs/Input_to_EC_Progress_Report_September_2011.pdf

⁶⁴ Kosovo 2010 Progress Report, fq. 53, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf

⁶⁵ Updated Assessment of the implementation by Albania of the roadmap for visa liberalisation – 19 April 2010, fq. 19,

<http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20Albania%20Assessment%2019%20April%202010.pdf>

Në anën tjetër, *Maqedonisë* i ishte dhënë vlerësim me nota më pozitive mbi këtë bllok, përkatësisht se ishte avancuar më tej korniza e avancuar ligjore e këtij vendi për luftimin e krimit të organizuar, në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore, narkotikëve dhe krimeve financiare. Më tej thuhej se strategjitë përkatëse po vazhdonin të zbatoheshin, si dhe po siguroheshin resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore dhe po ofroheshin trajnime të vazhdueshme për stafin përkatës. Ky vlerësim gjithashtu theksonte se bashkëpunimi në mes agjencive të zbatimit të ligjit ishte përmirësuar dhe se një bazë nacionale të dhënash të inteligjencës ishte në zhvillim e sipër. Edhe fusha e korrupsionit ishte vlerësuar si fushë me përparime të dukshme, në veçanti sa i përket hetimit të tij me anë të teknikave speciale dhe ngritjes së kapaciteteve të akterëve relevantë. Në fund, thuhej se gjithashtu ishin bërë përparime në përndjekjen e krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore dhe shpëlarjes së parave, ndërsa shtohet se duheshin vazhduar përpjekjet në vendosjen e një mekanizmi efikas të ndihmës së ndërsjellë juridike.⁶⁶

Sa u përket *Marrëdhënieve me jashtë dhe të drejtave themelore, Kosova* deri më tani ka themeluar 11 misione diplomatike⁶⁷ dhe 11 misione konsullore në shtetet që janë pjesë e Zonës Schengen (këto të fundit në tetë shtete).⁶⁸ Nga ana tjetër, të drejtat fundamentale nuk kanë qenë pjesë e PVLV 2009 - 2011, prandaj edhe nuk ka pasur raportim në lidhje me përparimin e arritur. Në përgjithësi, edhe në këto fusha përparimi mbetet i përzier. Sa i përket lirisë së lëvizjes, problemi i vetëm mbete në veri të lbrit, kurse në pjesën tjetër të territorit nuk ka ndonjë problem. Kur jemi te sigurimi i qasjes së plotë dhe efektive në dokumentet e udhëtimit dhe të identitetit për të gjithë qytetarët e Kosovës, sfida aktuale e pajisjes së të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas me to mund të adresohet përmes fushatave të vetëdijesimit dhe masave procedurale që do të nxisin ata të pajiseshin me këto dokumente, përfshirë me anë të kontrollit më të mirë të regjistrimit dhe pajisjes më numër personal të qytetarëve menjëherë pas lindjes. Edhe qasja për personat e zhvendosur përbrenda mbetet sfidë që adresohet vazhdimisht në kuadër të dialogut për liberalizimin e vizave që pritet të fillojë në mars të këtij viti.

Ndonëse nuk duket se ka zbrazësi në legjislacionin kornizë për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, përfshirë të drejtat dhe mbrojtjen e minoriteteve, legjislacioni zbatues ka akoma nevojë që të kompletohet, në veçanti në fushën e kundër-diskriminimit. Më tej, qytetarët duhet të vetëdijesohen më tepër që t'u drejtohen gjykatave për të mbrojtur të drejtat e tyre themelore, kurse ofrimi i ndihmës juridike falas është i domosdoshëm për të mundësuar këtë. Në anën tjetër, është e qartë se pas përfundimit të lustrimit, gjyqtarët dhe prokurorët kanë nevojë për udhëzime praktike mbi zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe interpretimin e tij nga institucionet gjyqësore, në mënyrë që të bëhen më proaktive në zgjidhjen e këtyre lloj rastesh. Pavarësia e plotë funksionale e Institucionit të Avokatit të Popullit është gjithashtu me rëndësi kyçe, në mënyrë që të monitorojë sistematikisht dhe në mënyrë rigorozë shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të udhëzojë e mbështesë qytetarët që gjithnjë e më shumë t'u drejtohen gjykatave në raste të shkeljes së të drejtave të tyre. Në anën tjetër, zyrat që merren me të drejta të njeriut në kuadër të institucioneve ekzekutive kanë nevojë për një reformë të plotë, në mënyrë që të zgjerojnë gamën e mekanizmave për të parandaluar shkeljen e të drejtave të njeriut nga institucionet ekzekutive, por edhe të ndërmarrin fushata të informimit të qytetarëve mbi legjislacionin për të drejtat e njeriut dhe mënyrat e realizimit të këtyre të drejtave duke përdorur kornizën ekzistuese të institucioneve ekzekutive, legjislative e gjyqësore. Sa i përket specifikimit të kushteve dhe rrethanave për fitimin e nënshtetësisë së Kosovës, nuk duket të ketë ndonjë problem, pasi që kjo është e rregulluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Shtetësinë e Republikës së Kosovës, si dhe akteve nënligjore e procedurale⁶⁹ në fuqi.

Vlerësimi pozitiv i KE-së për *Shqipërinë* në kuadër të këtij blloku fillon duke përmendur miratimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili parashihet themelimin e institucionit të Komisionarit për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili do të ketë kompetenca shumë të gjera, përfshirë ofrimin e asistencës viktimave të diskriminimit dhe

⁶⁶ Updated Assessment of the implementation by the former Yugoslav Republic of Macedonia of the roadmap for visa liberalisation – 18 May 2009, fq. 12, <http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20FYROM%20Updated%20visa%20assessment%2018%20May.pdf>

⁶⁷ Ministria e Punëve të Jashtme: Misionet Diplomatike të Republikës së Kosovës, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,49>

⁶⁸ Ministria e Punëve të Jashtme: Misionet Konsullore të Republikës së Kosovës, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,67>

⁶⁹ UA për Humbjen e Shtetësisë së Republikës së Kosovës me Lirim, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/UA_nr_04_2009.pdf; UA për Themelimin dhe Përcaktimin e Rregullave të punës së Komisionit për Shtetësi dhe Komisionit të Ankesave për Shtetësi, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/UA%20nr%2006.pdf>; UA për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Kosovës, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/UA%20nr%2017_2009.pdf; UA për Regjistrin e Shtetësisë së Kosovës, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/UA%20nr%2016_2009.pdf; Procedura e fitimit dhe humbjes së shtetësisë së Kosovës, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Procedura_e_fitimit_dhe_humbjes_se_shtetesisë_se_Kosoves.pdf

shqiptimin e gjobave ndaj shkelësve të këtij ligji. Më tej vlerësohet pozitivisht zbatimi i Strategjisë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së pjesëtarëve të komunitetit rom, iniciativat e ndërmarra në kuadër të Dekadës së Romëve për të promovuar integrimin e tyre në fusha të arsimit, kulturë dhe punësimit, dhe kërkohet që të vazhdohet me këto hapa pozitivë dhe të sigurohet alokimi i vazhdueshëm i resurseve të mjaftueshme për zbatimin e kësaj strategjie.⁷⁰

Në kuadër të këtij blloku **Maqedonia** ishte vlerësuar nga ana e KE-së më dobët se Shqipëria, pasi që një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të minoritetit rom ishte pa dokumente personale, se strategjia për integrimin e romëve po zbatohet ngadalë, dhe se një projektligj i përgjithshëm kundër diskriminimit ishte në procedurë të miratimit. Më tej thuhej se një numër i madh garancish kushtetuese që përmbante Marrëveshja kornizë e Ohrit ishin bërë pjesë e legjislacionit, strukturave institucionale dhe se po ndërmerreshin masa konkrete në zbatimin e tyre. Fusha e fundit, ajo mbi fitimin dhe humbjen e shtetësisë, vlerësohej të ishte pa probleme.⁷¹

⁷⁰ Updated Assessment of the implementation by Albania of the roadmap for visa liberalisation – 19 April 2010, fq. 39, <http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20Albania%20assessment%2019%20April%202010.pdf>

⁷¹ Updated Assessment of the implementation by the former Yugoslav Republic of Macedonia of the roadmap for visa liberalisation – 18 May 2009, fq. 22, <http://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20FYROM%20updated%20visa%20assessment%2018%20May.pdf>